Përdorimi i shtuar i sistemit të ujitjes. Fermerët e Kosovës po përdorin vetëm 30-40 përqind të kapaciteteve ekzistuese të ujitjes. Fermerë të tjerë përdorin ujë nëntokësor, duke zbrazur tavolinat e ujit, duke rezultuar në çështje me disponueshmërinë e ujit në verë, duke ndikuar në rendimentet përfundimtare dhe cilësinë e produkteve. Përdorimi i përmirësuar i ujitjes dhe burimeve ujore është një nga çështjet më të rëndësishme në zhvillimin e përgjithshëm të bujqësisë. Disa fermerë nuk janë të gatshëm të përdorin sistemet e ujitjes për të shmangur pagesën e tarifave të ujit, për shkak të perceptimit të mungesës së mundësive të tregut për produktet e tyre.

Financimi i sektorit të bujqësisë është ende i ulët. Disa banka në Kosovë nuk pranojnë huadhënien bujqësore, duke theksuar rreziqe të larta, përfitim të ulët dhe çështje me kolateral. Interesin i bankave për t'i dhënë hua sektorit është shumë i lartë dhe i pafavorshëm për fermerët dhe bizneset bujqësore. Sigurimi bujqësor do të zvogëlojë më tej rreziqet, por koha, informacioni dhe njohuritë janë të nevojshme për të rritur numrin e kredive dhe pjesëmarrjen e sektorit në portofolet më të gjera të kredive të bankave. Shumica e ndërmarrjeve në Kosovë ende po investojnë në infrastrukturë dhe kanë probleme të konsiderueshme me qasjen në kapitalin qarkullues, ndërsa bankat përqendrohen në kolateral dhe nuk janë ende të gatshme të përdorin mjete të tjera për të siguruar huatë e tyre (Bank, 2018).

2.3 Sektori i qumështit në Kosovë

Në krahasim me vitin 2017, në vitin 2018 kapituajt që shënuan rritje më të madhe në vlerën e importit në krahasim me vitin 2017 ishin produktet e qumështit (MBPZHR, Raporti i Gjelber,

2019). Me fondin blegtoral ekzistues të lopëve qumështore, vlerësohet se Kosova arrin të mbulojë 84% të kërkesave të tregut vendor, ndërsa për përmbushjen e nevojave vendore vazhdon të importojë rreth 16% të sasisë së qumështit dhe produkteve të tij. Eksporti i produkteve të njejta nga prodhuesit tanë është shumë i vogël dhe ka qenë i orientuar drejt vendeve të regjionit, kryesisht në Shqipëri (MBPZHR, Tregu i qumështit, 2015). Sasia e qumështit të importuar ka qenë mjaft e lartë ku sasia më e madhe është shënuar në vitin 2007 me 26 mil. litra. Zvogëlim të sasisë së importit të qumështit ka pasur në vitin 2009, kur është shënuar pika më e ulët për këtë periudhë kohore (13.5 mil. litra) ose 69% më pak se sa në vitin 2014. Sa i përket vitit 2014 Kosova më së shumti ka pasur import të qumështit nga Sllovenia (55%), Bosnja e Hercegovina (16%), Maqedonia (12%), Serbia (12%), Kroacia (2%) dhe pjesa tjetër e importit është nga vendet e tjera. Edhe pse sektori i qumështit qëndron shumë lartë në mesin e prioritetëve të qeverisë, përkundër mbështetjes së vazhdueshme, prodhimtaria e qumështit ende përballet me shumë vështirësi. Viteve të fundit prodhuesit vendor po mundohen ta tejkalojnë gradualisht konkurrencën e cila vjen nga produktet e importuara dhe tregtia jo-formale e qumështit dhe produkteve të tij të cilat përpunohen në shtëpi, e që shiten në tregjet e gjelbërta. Mesatarisht, për vitet 2005-2014 janë importuar 19 mil. litra qumësht në vit, ndërsa janë eksportuar 0.4 mil. litra, që do të thotë një deficit i lartë prej 19 mil. litra qumësht. (MBPZHR, Tregu i qumështit, 2015). Prodhimi i përgjithshëm i qumështit në vitin 2018 ishte 278 mijë tonë, e që është pak më i ulët sesa në vitin 2017 sepse numri i lopëve qumështore ishte më i vogël. Bilanci tregtar mbetet negativ me 30 mil. €. Konsumi për kokë banori ishte 168 kg në vit që do të thotë se një person konsumon rreth 0.5 kg në ditë duke përfshirë qumështin dhe produktet e tij (MBPZHR, Raporti i Gjelber, 2019). Qumështi dhe produktet e tij, hyjnë në grupin e të mirave bazë dhe kanë një konsum të përditshëm. Kërkesa për qumësht ka shënuar rritje të madhe në vitet e pasluftës. Vetëm nga viti 2005 deri në vitin 2013 kjo kërkesë është vlerësuar të jetë rritur për 28%. Kjo rritje ka qenë stabile dhe sektori në përgjithësi shënon një stabilitet sa i përket kërkesës ekonomike (Burim Ejupi, 2015).

	Njësia	2014	2015	2016	2017	2018
Lopë qumështore	krerë	134,393	135,801	136,783	132,971	132,474
Prodhimi i qumështit	t	278,933	282,534	285,261	277,976	277,599
Importi	t (p.e.)	67,863	67,491	69,284	68,007	70,596
Furnizimi	t (p.e.)	346,796	350,025	354,545	345,983	348,195
Eksporti	t (p.e.)	378	800	745	679	572
Përdorimi vendor	t (p.e.)	346,418	349,224	353,800	345,303	347,624
Shkalla e vetë-mjaftueshmërisë	%	80.5	80.9	80.6	80.5	79.9
Humbjet	t (p.e.)	5,579	5,651	5,705	5,560	5,552
Konsumi për ushqim të vëçave në fermë	t (p.e.)	41,003	41,532	41,933	40,862	40,807
Procesimi	t (p.e.)	26,690	26,868	27,247	26,606	26,848
Konsumi njerëzor	t (p.e.)	273,146	275,173	278,914	272,276	274,416
Çmimet e prodhuesit (në fermë)	€/kg	0.33	0.30	0.30	0.31	0.31
Vlera e prodhimit	mil EUR	76.7	70.6	71.3	71.8	71.7
Bilanci tregtar	mil EUR	-25.5	-25.5	-26.8	-28.5	-30.0

Figura 2.2 Bilanci i furnizimit për qumështin dhe produktet e qumështit të lopës, 2014-2018- Burimi: (MBPZHR, Raporti i Gjelber, 2019)

Subvencionimi i qumështit sipas cilësisë ka filluar për herë të parë në vitin 2014, ndërsa në vitin e pestë të subvencionimit, gjithsej shuma e subvencionimit është rritur më shumë se trefishi i vitit 2014. Subvencionimi për litër ka mbetur i njëjtë sikurse në vitin paraprak me 0.06/0.04/0.02 €/litër, varësisht klasave të cilësisë. Sa i përket mbështetjes së qumështit në bazë të cilësisë prin regjioni i Pejës me 37%, pasuar nga Gjakova me 24%, Prishtina 16% dhe regjionet e tjera me 23% .




Figura 2.3 Pagesat direkte për qumësht sipas cilësisë 2014-2018, në 1000 € (majtas); Subvencionet për qumësht sipas cilësisë sipas regjionit në %, 2018 (djathtas)
Burimi: (MBPZHR, Raporti i Gjelber, 2019)

2.3.1 Prodhimtaria vendore

Sektori i qumështit është sektori më i favorshëm në Kosovë duke kontribuar rreth 10 përqind në PBB-në totale, duke siguruar drejtpërdrejt punësim dhe duke përmirësuar të ardhurat e familjes rurale. Ekzistojnë shumë organizata kombëtare dhe ndërkombëtare të cilat e kanë mbështetur këtë sektor në Kosovë si Qeveria Zvicerane, Mbështetja e Biznesit të Kllasterit të Kosovës (KCBS-USAID), Shoqata Kosovare e Prodhuesve të Qumështit (KAMP), Agjencia Evropiane për Rindërtim - Projekti për Mbështetjen e Tregut (MSP- EAR), etj. Qëllimi ishte zhvillimi i sektorit të qumështit dhe përdorimi i tij si qumësht i freskët dhe si promovues që u mundëson fermerëve të Kosovës të shesin produktet e tyre të qumështit me çmim konkurrues dhe të përmirësojnë cilësinë e qumështit (Miftari, et al., 2008). Blegtoria gjeneron prodhim mesatar prej 298.4 mil. €1 në vit. Në këtë sektor dominojnë kryesisht fermat e vogla që mund të plotësojnë kërkesat e ekonomive familjare dhe një sasi shumë të vogël të prodhimit të tyre mund ta plasojnë në treg. Numri i fermave gjysmë komerciale dhe komerciale është mjaft i vogël por me tendencë të rritjes. Në fondin blegtoral, gjedhet janë në pjesëmarrje më të madhe, dhe janë bartës të prodhimit të qumështit dhe mishit në vend, përcjellur nga kafshët e imëta: delet dhe dhitë. Sipas Anketës së Ekonomive Bujqësore 2019, numri i gjedheve është 257 733 krerë (këtu është i përfshirë edhe numri i buallicave, meqenëse kjo kategori është me numër të vogël në Kosovë). Sipas përqindjes, pjesën më të madhe e përbën numri i lopëve qumështore me 51.19% dhe me 131, 939 krerë. Po ashtu, në këtë publikim janë prezantuar edhe numri i lopëve të tjera që për arsye të ndryshme, nuk janë lopë qumështore dhe që nuk marrin pjesë në reproduksion, numri i tyre është 2088 krerë (Ask, 2019). Prodhimi i qumështit të lopës është nën sektori më i rëndësishëm në prodhimtarinë blegtorale. Viteve të fundit janë bërë përpjekje për ta kthyer prodhimin e qumështit nga fermat e konsumit vetanak në ato të orientuara kah tregu. Sipas vlerësimeve të MBPZHR-së numri mesatar i lopëve qumështore në ekonomitë familjare bujqësore është 1-5 krerë, që përbëjnë shumicën e lopëve në prodhimtarinë e qumështit (94.2%), ndërsa vetëm 5.8% janë ferma komerciale që kanë mbi 5 krerë lopë qumështore. Fermat me mbi 5 krerë lopë qumështore janë furnizuesit kryesor të industrisë përpunuese të qumështit. Sipas të dhënave në vend janë 4,238 ferma me mbi 5 krerë lopë qumështore që dërgojnë në industrinë e qumështit afro 62 mil. litra qumësht në vit. Me fondin blegtoral ekzistues të lopëve qumështore, vlerësohet se Kosova arrin të mbulojë 84% të kërkesave të tregut vendor, ndërsa për përmbushjen e nevojave vendore vazhdon të importojë rreth 16% të sasisë së qumështit dhe produkteve të tij. Eksporti i produkteve të njejta nga prodhuesit tanë është

shumë i vogël dhe ka qenë i orientuar drejt vendeve të regjionit, kryesisht në Shqipëri. Tregu i përgjithshëm për qumësht dhe produkte të qumështit në Kosovë llogaritet të jetë 441 mijë ton në vit, përfshirë këtu qumështin e freskët dhe ekuivalentët e qumështit³. Kjo përfshinë gjithë prodhimtarinë vendore si dhe importin dhe eksportin e qumështit dhe produkteve të tij. Prodhimtaria vendore vlerësohet të jetë rreth 369 mijë ton qumësht lope, përmes së cilës janë plotësuar rreth 84% të nevojave për konsum të qumështit dhe 16% u mbuluan nga importi. Sipas të dhënave zyrtare të prodhimtarisë vendore si dhe të dhënave të shkëmbimit tregtar, rrjedh se në vitin 2013 për përdorim në fermë janë shpenzuar mesatarisht 181 mijë ton qumësht, sasia prej 54 mijë ton përdoret për ushqim të viqave, ndërsa humbje në fermë konsiderohet të jenë 7 mijë ton. Prodhimtaria e qumështit në vitin 2013, vlerësohet të jetë në vlerë monetare rreth 122 mil. Euro. Në Kosovë konsumi i përgjithshëm i qumështit për kokë banori ishte 0.59 litra/ditë (MBPZHR, Tregu i qumështit, 2015).

2.3.2 Eksporti dhe importi i qumështit

Prodhimi i qumështit në Kosovë bëhet nga fermat familjare, fermat komerciale që janë të specializuara vetëm me prodhimin e qumështit dhe fermat që janë pjesë e impiantit të përpunimit ose pikave të grumbullimit. Tregu informal (jeshil) që operon me qumësht të pasterizuar, kryesisht i furnizuar nga fermat familjare, dhe tregu zyrtar (supermarket, mini-treg, restorante) që operon kryesisht me qumësht të pasterizuar dhe furnizohet nga prodhuesit komercialë të qumështit dhe produkteve të qumështit. Prodhimi vendas përballet me një konkurrencë të madhe nga importet e qumështit, vendet kryesore nga të cilat importohet qumështi dhe produktet e qumështit janë Gjermania, Hungaria, Sllovenia, Bullgaria Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina dhe Turqia. Lidhur me eksportin e qumështit dhe produkteve të qumështit në Kosovë, si rezultat i vështirësitë me të cilat përballen përpunuesit e qumështit, sasi shumë të vogla eksportohen, kryesisht në Shqipëri dhe Maqedoni (Berbatovci, 2018).

Për ta zëvendësuar pjesërisht këtë import me produkte vendore, furnizimi me qumësht të freskët nga prodhuesit vendor duhet të rritet për rreth 123 milion litra në vit, ashtu që përpunuesit industrial vendor të mund të plotësojnë kapacitetet e tyre të instaluar. Një sasi e tillë do të ndihmonte prodhuesit vendor të marrin pjesë më të madhe në tregun e Kosovës, por poashtu do të rriste konkurrentshmërinë e tyre në tregje të eksportit. Gradualisht, konsumi do të lëvizte nga prodhimi për konsum vetanak, në konsum të produkteve të përpunara dhe paketuara. Për të arritur këtë sasi

shtesë të prodhimit të qumështit, vlerësohet se numri i lopëve qumështore në Kosovë ka hapsirë të rritet për rreth 20,000 krerë (Recura, 2020).

2.3.3 Tregu i qumështit

Kosova ka një potencial mjaft të mirë për zhvillimin e blegtorisë në të gjitha rajonet kodrinore malore të cilat janë karakteristike për këtë lloj veprimtarie. Prodhimi i qumështit është i përqendruar kryesisht në fermat e vogla, i cili pastaj kalon përmes qendrave grumbulluese deri tek njësitë përpunuese. Qumështi është një produkt bazë për konsumim nga çdo familje në Kosovë. Kërkesa për qumësht është zakonisht stabile, qoftë si produkt primar apo i përpunuar, ndërsa oferta në vitet e fundit ka shënuar një rritje të lehtë. Qumështi vendor plotëson rreth gjysmën e kërkesës së nevojave të konsumimit, prandaj më tepër se sa gjysma tjetër importohet (Recura, 2020). Megjithëse ka përmirësime të dukshme, megjithatë një theks i veçantë duhet t'i kushtohet zinxhirit të përpunuesve të qumështit si përbërësi kryesor në sektorin e qumështit p.sh. sigurimi i çmimeve për produktet me cilësi më të mirë, menaxhimi i cilësisë së qumështit në njësinë e përpunimit, përmirësimi i cilësisë së qumështit të freskët, prezantimi i produkteve të qumështit me cilësi më të mirë dhe studimi i faktorëve që ndikojnë në qumështin dhe produktet e qumështit dhesjellja e konsumatorit (Miftari, et al., 2008). Tregu i qumështit në Kosovë determinohet nga faktorë si kërkesa ekonomike, baza ligjore dhe numri aktual i operatorëve që merren me prodhimin dhe përpunimin e qumështit dhe produkteve të tij. Qumështi është një produkt bazë i cili është pjesë e çdo familjeje në Kosovë. Qoftë si produkt i parë, qoftë i përpunuar në produkte të tjera, kërkesa për qumësht është gati gjithmonë stabile dhe nuk ndryshon. Baza ligjore në këtë fushë është e gjerë dhe ajo përfshinë që nga ligjet bazike deri tek rregulloret dhe udhëzimet administrative të lëshuara nga institucionet e pavarura. 61% e popullatës së Kosovës jeton në zona rurale.⁴ Bujqësia mbetet një nga fushat kryesore ku ekonomitë familjare të këtyre zonave janë të koncentruara. Kjo shton

numrin e përgjithshëm të familjeve që merren me prodhimin e qumështit si aktivitetin kryesor ekonomik për të hyrat familjare. Qumështi dhe produktet e tij, hyjnë në grupin e të mirave bazë dhe kanë një konsum të përditshëm. Kërkesa për qumësht ka shënuar rritje të madhe në vitet e pasluftës. Vetëm nga viti 2005 deri në vitin 2013 kjo kërkesë është vlerësuar të jetë rritur për 28%. Tani, sektori i qumështit mund të përcaktohet si një industri e përbërë nga dy sektorë: fermerë të vegjël që synojnë të përmbushin nevojat e tyre dhe fermerë komercialë që prodhojnë vetëm për treg. Rreth dy të tretat e qumështit të përgjithshëm dhe produkteve të qumështit të prodhuara në Kosovë konsiderohet se përdoren për konsum familjar ose shiten në “tregun e gjelbër”, ndërsa një e treta importohet (Miftari, et al., 2008). Tregu i qumështit është një nga sektorët agro-ushqimor me rritje më të shpejtë në Kosovë, megjithatë struktura e fermës është e fragmentuar. Niveli i produktivitetit është

më i ulët krahasuar me nivelet e Bashkimit Evropian dhe tregon potencial për përmirësime.

Konsumi i produkteve të qumështit pritet të rritet për shkak të rritjes së të ardhurave dhe segmentimit të konsumatorëve që do të





Figura 2.4 Kërkesa për qumësht sipas sezonave

Burimi: (Miftari, Preferencat e sjelljes konsumatore të Kosovarëve dhe kërkesa për qumësht dhe produkte të, 2009)

reflektonin preferenca të ndryshme për produktet me pak yndyrë ose me yndyrë zero, produktet me aditivë natyralë, etj. Në nivelin e tregut, një pjesë e konsiderueshme e qumështit të konsumuar dhe produkteve të qumështit importohet (Haas, et al., 2016). Shitja e produkteve të qumështit që vijnë nga fermat e qumështit në Kosovë varet nga cilësia e qumështit të freskët të prodhuar nga ato fermat. Furnizimi i përpunuesve të qumështit me qumësht cilësor është thelbësor për prodhimin e produkteve përfundimtare të qumështit me cilësi të lartë që konsumatorët do të blejnë. Për të përmirësuar cilësinë e qumështit produkteve, është thelbësore të përmirësohet marrëdhënia midis fermerëve të qumështit, përpunuesve të qumështit dhe shitësve me pakicë në rregull për të shmangur problemet e mundshme; lidhjet e komunikimit duhet të jenë themeluar dhe shfrytëzuar

rregullisht, që nga koha aktuale problemet me cilësinë e produkteve të qumështit janë kryesisht për shkak në komunikimin e pakët midis aktorëve të interesuar zinxhiri i furnizimit të industrisë së qumështit. Për më tepër, për të përmirësuar konkurrencën, besimi duhet të vendoset me partnerët në zinxhiri i furnizimit me qumësht (Musliu, Gjonbalaj, Sherifi, & Meqe, 2009). Arritjet e fundit shkencore kanë ndikuar në mënyrë të konsiderueshme në menaxhimin e bagëtive, rritjen e shkallës së prodhimit të tyre dhe gjithashtu ka mundësuar ndryshimin e strukturës së racës me qëllim të përmbushjes së nevojave të modernes shoqërinë nga produktet e tyre. Prandaj, zhvillimi i kapaciteteve prodhuese, veçanërisht prodhimi i qumështit ka ndikuar në krijimin e racave të larta të prodhimit dhe rritjen e racave në mbarë botën e mjeljes. Si në shumë ferma tregtare në Evropë, edhe në Kosovë në fermat e qumështit racat kryesisht të dominuara janë: Holstein (E Zezë dhe e Kuqe), Brawn Swiss, Simmental dhe Montbeliard. Në Alpe (kryesisht në Austri dhe Itali) dhe në disa zona malore në

Kosovë mund të gjendet Tirol Grey (Bytyqi, et al., 2009). Sektori i qumështit është një sektor i rëndësishëm me investime të mëdha kapitale dhe potencial për zgjerim. Në vitet e fundit, u bënë përpjekje për të lëvizur prodhimin e qumështit nga konsumi vetanak drejt prodhimit për tregun tregtar duke përmirësuar gjenetikën e tufave, duke futur praktika të mira bujqësore në fermat e qumështit dhe duke rritur aftësinë e fermerëve për të prodhuar qumësht me cilësi të lartë. Ndërsa këto investime janë përmbushur me sukses, importet mbeten të larta. Lopët qumështore



Burimi: (Recura, 2020)

Figura 2.5 Zinxhiri i vlerës në sektorin e qumështit

përfaqësonin 52 përqind të numrit të përgjithshëm të gjedheve në vitin 2016. Nga furnizimi i përgjithshëm me qumësht, 80 përqind u prodhua në vend, dhe bilanci u mbulua nga importet. Prodhimi i përgjithshëm i qumështit në vitin 2016 ishte 285 mijë tonë, pak më i lartë se në vitin 2015 (Bank, 2018).

2.4 Zinxhiri i vlerës së qumështit

Kosova ka pasur gjithsej 132,474 krerë lopësh në vitin 2018. Produktet kryesore të fermave janë mishi dhe qumështi. Figura në vijim tregon lëvizjen e produktit të qumështit dhe funksionet kryesore vertikale nga poshtë – lart, prej prodhimit në nivel ferme e deri tek akterët kryesorë, të cilët marrin pjesë në kryerjen e këtyre funksioneve, kështu realizojnë transaksione mes veti duke mundësuar funksionimin e ZV.

2.4.1 Prodhimi

Nga sasia e përgjithshme e qumështit të prodhuar në fermat e Kosovës, rreth dy të tretat e sasisë konsumohet brenda fermave dhe një e treta dërgohet direkt tek qumështoret ose dërgohet përmes qendrave grumbulluese të qumështit. Sipas të dhënave të MBPZHR prodhimi i përgjithshëm i qumështit në vend në vitin 2018 ka qenë rreth 278 milion litra, sasi e cila paraqet rënie për 1% krahasuar me vitin paraprak. Gjatë periudhës së analizuar pesëvjeqare, rendimenti mesatar për krerë lope është nën 175 litra në muaj. Ky rendiment aktual është mjaft i ulët, dukshëm nën mesataren botërore dhe bile edhe nën normën e parashikuar komerciale të nevojshme. Numri i lopëve qumështore për periudhën 2014 deri në vitin 2018 mbetet i ngjajshëm. Një rritje e vogël për 1% është paraqitur në vitin 2015 dhe 0.7% në vitin 2016, ndërsa në vitin 2017, numri i lopëve qumështore ka rënë për -2.8% krahasuar me vitin paraprak dhe në vitin 2018 ka shënuar një rënie tjetër për -0.4% krahasuar gjithnjë me vitin paraprak. Ndërsa, prodhimi vjetor i qumështit ka pasur një rritje të lehtë deri në vitin 2016 ku ka arritur në mbi 285 milion litra/vit. Një vit më pas, prodhimi i qumështit ka rënë për -2.6% ndërsa në 2018 krahasuar me 2017 u regjistrua një rënie tjetër prej -0.1% në prodhimin e qumështit. (Recura, 2020).

Kategoria	Njësia	2014	2015	2016	2017	2018
Prodhimi i qumështit	Ton	278,933	282,534	285,261	277,976	277,599
Diferenca ndër vite			3,601	2,727	- 7,285	- 377
Diferenca në përqindje			1.3%	1.0%	-2.6%	-0.1%
Lopë qumështore	Krerë	134,393	135,801	136,783	132,971	132,474
Diferenca ndër vite			1,408	982	- 3,812	- 497
Diferenca në përqindje			1.0%	0.7%	-2.8%	-0.4%
Mujore Litra / lopë		172.96	173.38	173.79	174.21	174.62

Figura 2.6 Prodhimi i qumështit dhe numri i lopëve qumështore ndër vite sipas raportit të gjelbër 2019
Burimi: (Recura, 2020)

Njëra nga arsyet e rendimentit të ulët të shënuar në Kosovë lidhet edhe me varietetet mikse të lopëve të kultivuara në Kosovë, të cilat në shumicën e rasteve janë raca të përziera dhe jo të specializuara qumështore. Përveç kësaj ushqimi i përdorur për lopët qumështore në shumë raste nuk është kombinimi ideal për të nxitur rendimentin e lartë të qumështit (Recura, 2020). Nga gjedhet, rolin më të rëndësishëm e kanë lopët qumështore, që paraqesin specifikën kryesore të mbajtjes së gjedheve, për shkak të prodhimtarisë së qumështit. Numri i lopëve qumështore ishte 131 939 krerë, kurse pjesëmarrja e lopëve qumështore në numrin total të gjedheve arrin 51.19% (Ask, 2019).

2.4.2 Cikli i prodhimit të qumështit

Sipas kalendarit të prodhimit të qumështit, viçat e gjinisë femrore që lindin mbahen në fermë për prodhimin e qumështit në të ardhmen. Në moshën 15-18 muaj, viçat janë të mbarësuar dhe pas nëntë muajsh mëshqerrat pjellin dhe fillojnë ciklin e parë të prodhimit të qumështit. Cikli i prodhimit të qumështit të lopëve qumështore fillon pas lindjes së viçit të parë dhe zgjat mesatarisht rreth 10 muaj, ndërsa një lopë del nga prodhimi pas 6 cikleve. Lopët mbahen në nxehtësi sapo të kalojnë periudhën 10 ditore pas pjelljes, zakonisht ato mbarësohen pas 30-60 ditësh. Fermerët e Kosovës zakonisht i mjelin lopët e qumështit për rreth 10 muaj (305 ditë) e cila përcillet me periudhën e thatë prej 60 ditësh. Në praktikë secila lopë lind gjatë sezonës së pranverës. Ndërsa kulminacioni i laktacionit për lopët qumështore të Kosovës është prej muajit Maj deri në Muajin Korrik (Recura, 2020).

2.4.3 Grumbullimi i prodhimit vendor

Përbrenda kategorisë së aprovimit të objekteve të ushqimit me prejardhje shtazore është e regjistruar vetëm një qendër grumbulluese, ndërsa nga burimet jo-zyrtare numërohen mbi 50 qendra grumbulluese të qumështit. Zakonisht grumbullimi i qumështit organizohet nga

qumështoret të cilat ofrojnë transport adekuat me frigorifer për të grumbulluar qumështin nga njëësia prodhuese. Qumështi është një produkt i cili lehtë mund të priset dhe për këtë arsye pas mbarimit të procesit të mjeljes duhet të ruhet si duhet. Pas mjeljes, qumështi pothuajse ka temperaturën e trupit dhe paraqet një të mjedis të përshtatshëm për rritje të shpejtë të bakterieve. Duke pasur parasysh se sistemi i natyrshëm pengues i qumështit kundër bakterieve zgjat vetëm 2-3 orë, pajisja me frigoriferë e qendrave grumbulluese apo transporti me ftohës është esencial. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) ka aplikuar pagesa direkte (subvencione) për qumështin sipas kategorive të cilësisë. Fermeri duhet të dorëzojë së paku 1,500 litra qumësht në qumështore të licencuar brenda periudhës tremujore (sipas tremujorëve të vitit kalendarik). Me këtë fermeri përfiton 0.06 €/litër për qumështin e klasës ekstra, 0.04 €/litër për qumështin e klasës së I-rë dhe 0.02 €/litër për qumështin e klasës së II-të (Recura, 2020).

2.4.4 Përpunimi

Sipas regjistrimit të Agjencionit të Ushqimit dhe Veterinës (AUV) të vitit 2019, gjithsejt janë 45 objekte të aprovuara për përpunim dhe paketim të qumështit në Kosovë, 7 prej të cilave për momentin janë jo-aktive. Subjektet aktive të cilat janë të shpërndara në rajone të ndryshme të vendit, prodhojnë produkte të ndryshme të qumështit si: qumësht i pasterizuar, qumësht UHT, jogurt, djathë i butë i bardhë, djathë kaçkavall, djathë sharri, gjizë, ajka, ajran, kos, vaj krem, mazë, specia me gjizë dhe akullore. Ndarja e ndërmarrjeve sipas kapacitetit të prodhimit është paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Vëllimi i prodhimit (lit)	Nr. i ndërmarrjeve	Kapaciteti (lit/ditë)	Kapaciteti (Litra/vit)
Deri në 5,000	24	32,750	11,953,750
5,000- 50,000	10	179,000	65,335,000
50,000- 200,00	3	380,000	138,700,000
Total	37	591,750	215,988,750

Figura 2.7 Kapaciteti i instaluar për përpunimin e qumështit në qumështoret në Kosovë sipas madhësisë
Burimi: (Recura, 2020)

Kapaciteti përpunues i qumështit tek ndërmarrjet vendore është dukshëm më i lartë se sa prodhimi i qumështit vendor i qumështit. 37 përpunues aktiv momental kanë kapacitet përpunimi total prej rreth 592 mijë litra qumësht në ditë apo rreth 216 milion litra në vit, e cila sasi llogaritet të jetë tregu vendor me shumicë për qumësht të freskët. Mirëpo, nga ana tjetër, afër dy të tretat e prodhimit të qumështit vendor mbetet në ferma për konsumim

vetanak, për t'i ushqyer viçat apo për ta shitur në tregun e gjelbër, ndërsa vetëm një e treta e prodhimit vendor dërgohet tek ndërmarrjet përpunuese. Pra, nga sasia totale prej 278 milion litrash të qumështit të prodhuar në vend vetëm 93 milion litra dërgohet në përpunim, e cila sasi i përmbush vetëm 43% të kapacitetit të ndërmarrjeve përpunuese. Kështu duke lënë një hapsirë tregu me kërkesë prej 123 milion litra qumësht në vit, e cila paraqet diferencën në mes të kërkesës nga përpunuesit dhe ofertës nga fermeri. Në mënyrë që fermerët Kosovarë të furnizojnë këtë treg të sigurtë, duhet të konsiderohet



Figura 2.8 Qumështi dhe produktet e qumështit

Burimi: (Recura, 2020)

shtimi i numrit të lopëve për rreth 20,000 krerë dhe njëkohësisht aplikimi i praktikave të mira të menaxhimit të fermës për të rritur rendimentin aktual (Recura, 2020).

2.4.5 Shitja dhe çmimi i tregut

Në vitin 2019, çmimi mesatar i tregut me pakicë për qumështin vendor sillet 0.45 - 0.50 Euro /litër, çmimi i qumështit të freskët të pasterizuar është rreth 0.50 Euro /litër ndërsa i atij të trajtuar me UHT, është rreth 0.90 Euro /liter. Çmimi i shitjes së qumështit nga ferma tek qumështoret shënon një rënie në sezonën e pranverës dhe arrin në minimum ngase rritet oferta, e cila sezonë zakonisht fillon në muajin Maj. Pastaj, prodhimi i qumështit zvogëlohet deri sa të fillon “tharja e lopëve” gjatë sezonit vjeshtë / dimër, në të ciën periudhë ato nuk mjelen për dy muaj. Gjatë kësaj periudhe rritet kërkesa për qumësht prandaj edhe çmimi është më i lartë (Recura, 2020).

Produkti	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Qumësht	0.32	0.33	0.33	0.30	0.30	0.31	0.31	0.32
Norma		3.1%	0.0%	-9.1%	0.0%	3.3%	0.0%	3.2%

Figura 9 Çmimet mesatare vjetore të shitjes me shumicë së qumështit nga fermat e qumështoret 2012 -2019

Burimi: (Recura, 2020)

2.4.6 Konsumi

Konsumi vjetor i produkteve të qumështit në Kosovë vlerësohet të jetë rreth 289 milion kg, duke llogaritur 166 kg / vit për kokë banori, apo 0.5 kg / ditë për kokë banori. Nëse përlogaritet që përpunuesit vendor industrial kanë hise prej vetëm 33% të tregut të produktit final, atëherë del se

shumica e sasisë së qumështit të prodhuar në vend konsumohet brenda familjeve ku prodhohet dhe nuk përfundon tek përpunuesit industrial të cilët kanë kërkesa të vazhdueshme. Për ta zëvendësuar pjesërisht këtë import me produkte vendore, furnizimi me qumësht të freskët nga prodhuesit vendor duhet të rritet për rreth 123 milion litra në vit, ashtu që përpunuesit industrial vendor të mund të plotësojnë kapacitetet e tyre të instaluar (Recura, 2020).

2.5 Qumështi UHT

2.5.1 Teknika e pasterizimit në UHT

Në procesin e temperaturës ultra të lartë (UHT), qumështi i nënshtrohet temperaturave mbi 135 ° C për disa sekonda duke i dhënë një produkti me një afat prej disa muajsh. Cilësia e qumështit të papërpunuar, procesi i UHT dhe kushtet e ruajtjes ndikojnë në qëndrueshmërinë (Karlsson., et al., 2019). Pasterizimi i UHT është i njohur edhe si pasterizimi i ultra-me temperaturë të lartë (UHT). Kjo zakonisht përfshin ngrohjen e qumështit ose kremës në 140 ° C (284 ° F) për 4 sekonda. Qumështi është i paketuar në enë sterile të mbyllura hermetikisht. Prandaj, mund të ruhet deri në 90 ditë pa kushte frigoriferike. UHT përdoret zakonisht në pasterizimin e qumështit por mund të përdoret edhe për lëngjet e frutave, kremin, qumështin e sojës, kosin, verën, supat, mjaltin dhe qepën. Qumështi UHT u përdor për herë të parë në 1960 (Chavan, Chavan, Khedkar, & Jana, 2011).

2.5.2 Historia e Qumështit UHT

Konsumatorët kërkojnë ushqime sa më të freskëta me veti të mira ndijore (veçanërisht shije), përveç kësaj duke qenë të sigurt dhe duke pasur një jetë të konsiderueshme në raft, por pa aplikuar aditivë. Për shkak të vlerës së tij të lartë ushqyese, qumështi është një medium i shkëlqyeshëm për rritjen mikrobiologjike. Si pasojë, qumështi i freskët kërkon një trajtim termik në mënyrë që të garantojë një produkt të sigurt dhe të qëndrueshëm në raft. Teknika e aplikuar më shpesh për të arritur këtë është trajtimi i nxehtësisë. Sistemi i parë i përbërë nga ngrohje indirekte me rrjedhje të vazhdueshme (125 ° C për 6 min) është prodhuar në 1893. Patentuar në 1912, metoda e ngrohjes së vazhdueshme me rrjedhje të drejtpërdrejtë përzihet me avull me qumësht për të arritur temperatura nga 130 në 140 ° C. Zhvillimi i procesit UHT u pengua për shkak të kontaminimit të mundshëm pa sisteme komerciale aseptike. Në vitin 1953, qumështi UHT u mbush në mënyrë aseptike në kanaçe pas trajtimit të nxehtësisë me një përpunues Uperiser® të ndjekur nga kartona kartoni tetrahedral në 1961 (Datta & Deeth, Diagnosing the cause of proteolysis in UHT milk,

2007). Zhvillimi i përpunimit aseptik në Shtetet e Bashkuara filloi përmes përpjekjeve të C. Olin Ball, dhe procesi i mbushjes së nxehtë dhe të ftohtë u komercializua në 1938 për një pije qumështi çokollate. Në 1942, procesi Avoset u përdor për të paketuar një produkt krem duke përdorur një sistem të vazhdueshëm të ajrit të nxehtë dhe llambat ultraviolet (UV) në zonën e mbushjes dhe mbylljes. Në 1948, procesi aseptik Dole i zhvilluar nga William McKinley Martin u përdor për supë bizele dhe qumësht të sterilizuar. Real Fresh, Inc. u bë qumështorja e 2-të në Shtetet e Bashkuara në 1952 për të përdorur UHT dhe paketim pa mikrobe (AP), dhe në 1981, ishte paraardhësi në përdorimin e peroksidit të hidrogjenit (H₂O₂) për të sterilizuar materialin e paketimit (Chavan, Chavan, Khedkar, & Jana, 2011).

2.5.3 Parimet e përpunimit të qumështit UHT

Trajtimi i nxehtësisë në prodhimin e produkteve me jetë të gjatë quhet "sterilizim". Në procese të tilla, produkti i trajtuar është i ekspozuar ndaj një trajtimi të tillë të fuqishëm të nxehtësisë që mikroorganizmat përkatës dhe shumica e enzimave janë inaktivuar, dhe produkti i përpunuar ka dhënë cilësi të shkëlqyera mbajtëse dhe mund të ruhet për disa muaj në kushte të ambientit. , i cili bën pa ndryshim kimik në krahasim me përpunimin e replikës (Datta & Deeth, Diagnosing the cause of proteolysis in UHT milk, 2007). Karakteristikat e produktit, të tilla si pH, aktiviteti i ujit, viskoziteti, përbërja dhe oksigjeni i tretur, tregojnë kushtet e përpunimit të nevojshme për të arritur sterilitetin tregtar. Kriteret e përzgjedhjes së sistemit UHT reflektojnë preferencat e klientëve. Proceset e prodhimit janë krijuar për të siguruar sterilitetin tregtar dhe atributet e pranueshme ndijore gjatë gjithë afatit të përdorimit (Chavan, Chavan, Khedkar, & Jana, 2011).

2.5.4 Ndryshimet kimike në qumështin UHT

Përpunimi i drejtpërdrejtë i nxehtësisë jep ndryshime kimike më pak të pafavorshme krahasuar me përpunimin indirekt të nxehtësisë (Dhakal, Datta, & Deeth, 2003). Sistemi indirekt i vazhdueshëm i tubave të mbështjellë, koha e mbajtjes së procesit përbënte > 80%, koha e ngrohjes së procesit <10% dhe faza e ftohjes <2% e ndryshimeve kimike të akumuluar (Varzakas, 2008). Ngrohja ka pak efekt në kripërat e qumështit me 2 përjashtime, karbonatet dhe fosfatet e kalciumit. Pjesa më e madhe e karbonatit potencial ndodh si CO₂, i cili humbet nga nxehtësia, me një rritje konsekuente të pH. Ndër kripërat e qumështit, fosfati i kalciumit është unik në atë që tretshmëria e tij zvogëlohet duke rritur temperaturën. Gjatë ngrohjes, fosfatesipiton kalciumi i tretshëm në mikelët e kazeinës, me një ulje shoqëruese në përqendrimin e joneve të kalciumit dhe pH. Rritja e ciditetit oksidativ të qumështit është reagimi i oksigjenit në përbërësit e yndyrës së qumështit që rezulton

në aldehid me zinxhir të shkurtër dhe të paqëndrueshme të ketonit. Inaktivizimi i enzimës është një ndryshim kimik pozitiv i përpunimit të UHT. Vitaminat e tretshme në yndyrë ndikohen minimalisht nga nxehtësia, ndërsa vitaminat e tretshme në ujë mund të shkatërrohen pjesërisht në përpunimin e UHT. Një reduktim i ndjeshëm i vitaminës B1 (tiamin), B2 (ribo fl avin), B3 (niacinë), B6, B12 dhe folateve është raportuar nën ndikimin e përpunimit të qumështit të ndryshëm (Chavan, Chavan, Khedkar, & Jana, 2011).

2.5.5 Faktorët që ndikojnë në ruajtjen e afatit të ruajtjes së qumështit UHT

Mosha e lopës- Qumështi nga lopët e vjetra krijon xhel më shpejt se ai i lopëve të reja (Datta & Deeth, Diagnosing the cause of proteolysis in UHT milk, 2003).

Faza e laktacionit- (Coats, Auld, Sutherland, & Hardham, 1996) raportuan se qumështi i hershëm i laktacionit UHT u bë xhel në 5 deri në 6 muaj, ndërsa qumështi i laktacionit të vonë nuk u bë xhel 9 muaj pas eksperimentit të tyre. Arsyeja prapa fenomenit është se sasia më e madhe e proteinave të hirrës së denaturuar kompleksohet me kazeinë në qumështet e laktacionit të vonë, krahasuar me homologët e laktacionit të hershëm (Chavan, Chavan, Khedkar, & Jana, 2011).

Mastiti- Qumështi mastik (domethënë qumështi me numër të lartë të qelizave somatike, SCC) i nënshtruar trajtimit UHT është më i ndjeshëm ndaj xhelatimit sesa qumështi normal. Kjo i është atribuar aktivitetit proteolitik të rrudhur që rezulton nga një nivel i ngritur i plazminës.

Sezoni- Ndryshimet sezonale në përbërjen e qumështit mund të ndikojnë indirekt në sjelljen e xhelatimit të qumështit të sterilizuar nga UHT. Qumështi i vjeshtës dhe pranverës tregon më shumë probleme të xhelatimit të moshës sesa qumështi i prodhuar në sezone të tjera; kjo mund t'i atribuohet përbërjes minerale të qumështit. (Manji, Kakuda, & Arnott, 1986) vënë re se qumështi i prodhuar midis gushtit dhe tetorit ishte më i prirur për xhel gjatë ruajtjes sesa ai i prodhuar gjatë pjesës së mbetur të vitit. Qumështi i pranverës ka vlera më të larta të pH, laktozës, fosfatit të tretshëm dhe hidratimit mikellar se qumështi i mbledhur në vjeshtë, ndërsa qumështi i pranverës ka qëndrueshmëri të ulët të yndyrës dhe nxehtësisë (Gaucher, et al., 2008).

Cilësia mikrobiologjike e qumështit të papërpunuar- Qumështi me një numër të lartë mikrobesh të parapërpunimit është më i ndjeshëm ndaj formimit të xhelit sesa qumështi me një numër të ulët. Mikroorganizmat që prodhojnë enzima të qëndrueshme në nxehtësi shkaktojnë

problemet më serioze të xhelacionit. Kohët më të gjata të ftohjes para sterilizimit lejojnë rritjen e rrudhur të mikroorganizmave psikrotrope dhe prodhimin shoqërues të enzimave të qëndrueshme në nxehtësi, veçanërisht të proteinave dhe lipazave (Chavan, Chavan, Khedkar, & Jana, 2011).

KAPITULLI 3 - METODA DHE METODOLOGJIA E PUNIMIT

Gjatë këtij hulumtimi kam përdorur studimin primar dhe studimin sekondar. Kombinimi i këtyre dy modeleve, më ka mundësuar një informacion më të detajuar për çështje komplekse dhe gjithashtu edhe për natyrën e evoluimit të zbatimit strategjik.

Në kuadër të rishikimit të literaturës kemi përdorur studimin sekondar, gjithashtu kemi përdorur edhe publikimet, raportet dhe ueb faqet e ndryshme që na kanë ndihmuar në ndërtimin e një teme të dobishme për sektorin.

Pyetësi është realizuar në kuadër të hulumtimit, janë anketuar personat kompetentë të kompanisë vendore “Drena” në Skënderaj dhe ekspertë të fushës, kështu është fituar një pasqyrë e zinxhirit të tanishëm të vlerës të qumështit UHT në veçanti. Pyetësi është realizuar vetëm me ekspertë të fushës, kështu duke përfshirë profesorë të Fakultetit të Bujqësisë, zyrtarë të Ministrisë së Bujqësisë, njohës të fushës nga USAID dhe GIZ, përfaqësues të qumështores Drena dhe qumështoreve tjera vendore, dhe njohës të fushës me një përvojë shumëvjeçare në bujqësi. Për vlerësim dhe analizim të zinxhirit të vlerës kemi përdorur “Metodën e vlerësimit të shpejtë”. Metoda e formuluar dhe aprovuar nga FAO, e cila është provuar dhe ka dhënë një qasje të zbatueshme dhe me kosto efektive për analizën e sistemeve ushqimore. Në përgjithësi, shumë organizata qeveritare dhe joqeveritare kanë adoptuar këtë qasje të përgjithshme në studime, dhe kanë gjeneruar një grup të madh informacioni mbi organizimin dhe performancën e zinxhirëve të vlerës të kulturave të ndryshme bujqësore ose produkteve bujqësore, në nivelet kombëtare dhe rajonale. Pyetësi është i ndarë në tri pyetje thelbësore që përfshijnë:

-Kontrollueshmeria;

-Relevanca;

- Pesha

Këto tri pyetje kanë marrë përgjigje në secilin faktor dhe nënfaktorë të pyetësorit në mënyrë që në fund të hulumtimit kemi fituar një gjendje reale të zinxhirit të vlerës në sektorin e qumështit në Kosovë.




Figura 10 Faktorët testues në pyetësozin sipas "Metodës së vlerësimit të shpejtë"

Gjatë punimit të dhënat janë përpunuar me anë të programit të excelit. Kemi përdorur metodat siç është metoda e krahasimit, metoda përshkruese dhe metoda analitike. Rezultatet e fituara janë të dobishme për sektorin dhe hulumtimet që do të bëhen në vazhdimësi.

KAPITULLI 4 – QUMËSHTORJA “DRENA”

4.1 Historiku i kompanisë


4.1.1 Kush është Drena?

Drena është një kompani që merret me prodhimin e qumështit dhe nënprodukteve të tij 100% të freskëta dhe natyrale, si: jogurt, ajran, kumshtë, kos, gjizë, mazë, tëlyen, djathë lope, dhie, deleje & buallice. Ndër të tjera, Drena është prodhuesi i vetëm në Ballkan i Mozzarellaës së buallicës. Në shekullin e 14-të, qumështi i lopës u bë më i popullarizuar sesa ai i deles. Luis Pasteri, një mikrobiolog francez, udhëhoqi testin e parë të pasterizimit në vitin 1862. Pasterit i atribuohen meritat për revolucionarizimin e sigurisë së qumështit dhe, rrjedhimisht, mundësisë për të deponuar dhe shpërndarë qumështin përtej fermës. Që nga viti 2015, edhe kompania Drena është pjesë e kësaj tradite të lashtë njerëzore. Ndonëse relativisht e re në treg, kushtimi për kualitet të veçantë dhe dëshira e madhe për të prodhuar produktin më të mirë për çdo ditë... është ajo që na veçon. Me fabrikën saj në Skenderaj dhe pikën shpërndarëse në Fushë Kosovë, kompania Drena bën grumbullimin e qumështit nga fermerë lokalë. Marrëdhëniet e forta me fermerët përbëjnë një gurë-themel të fortë për një kualitet të qëndrueshëm të produkteve të Drenës. Nëpërmjet përkushtimit të punëtorëve tanë, ne i shërbejmë komunitetit. Me produkte origjinale, ne sot ushqejmë familjet kosovare dhe promovojmë lumturi (Drena, 2020). Në nëntor të vitit 2017, Komiteti Zgjedhor për International Food & Beverage Quality Award zgjodhi Drena SHPK për çmimin e vitit. Vendimi i tyre u bazua në informatat e marra nga 7500 ndërmarrës anëtarë të Klubit Global Trade Leaders nga 90 vende të ndryshme. Ky çmim u krijua nga Klubi Global Trade Leaders, me qëllim që t'i dallojë kompanitë e çdo dege industriale, produktet dhe shërbimet e të cilave kanë merituar njohje dhe lavdërim publik përgjatë vitit. Çmimi në fjalë promovon filozofinë e kualitetit në industrinë e ushqimit dhe të pijes, gjë që u mundëson ndërmarrjeve arritjen e ekselencës në prodhim dhe distribuim (Drena, 2020).



4.1.3 Misioni i Drenës

Misioni ynë është të frymëzojmë një shoqëri të shëndoshë duke lidhur njerëzit me ushqim të vërtetë. Ndërsa rritemi së bashku, ta rrisim dhe kënaqësinë e blerësve duke ofruar prodhimet më të freskëta në



mënyrën më miqësore, me nder dhe me komunikim të sinqertë. Ne besojmë që kujdesi për kafshët dhe mirëqenien e tyre është thelbësor për prodhimin e një qumështi me kualitet të lartë. Fabrika e Drenës merr qumështin nga fermerë vendorë, që nuk i mbajnë kafshët e tyre të ndara nga natyra. Kultivimi i kafshëve në kullosa të zonave të pastra, larg tymit dhe pluhurit të qytetit, dhe lëvizja e tyre nën rrezet e diellit ndikojnë drejtpërsëdrejti në shëndetin e kafshës dhe nivelin e kualitetit të produkteve tona, që tashmë njihet dhe pranohet ndërkombëtarisht (Drena, 2020). Të gjitha produktet tona kanë emra origjinalë. Ku secili konsumatorë do ta ketë të lehtë ta identifikojë produktin e shijes së tij me emrin e vacantë. Ne në vazhdimësi do të hulumtojmë që të ecim me kohën në gjetjen edhe të recetave të reja me shije dhe cilësi të reja. Do të prodhojmë llojet e kërkuara nga konsumatorët. Konsumatori ynë gjithmonë do të jetë parësori. E gjithë puna jonë gjithmonë do të ketë varësi nga dëshirat e konsumatorëve tanë. Ata do të jenë klasa me respektuar e jona, pa të cilët ne asnjëherë nuk do të mund të qëndrojmë. Ne do të jemi të sinqertë dhe to të punojmë për të plotësuar shijet e tyre. Gjithmonë do t'i trajtojmë si familje jona e ngushtë, duke i shërbyer me produkte të sigurta, cilësore dhe të shëndetshme. Secili ndryshim apo investim i yni do të jetë në shërbim të tyre (Drena, 2020).

4.1.4 Struktura organizative e Drenës

Qumështorja Drena vepron sipas strukturës organizative të paraqitur më poshtë.




Figura 4.1 Struktura organizative në qumështoren "Drena"

(D.Thaci, 2018)

4.2 Teknologjia

Në qumështoren Drena respektohet çdo hallkë e zingjirit, duke filluar nga trajtimi i kafshëve ku përmes ushqimit cilësor e trajtimit të mirëfilltë, arrijmë të kemi qumështin me kualitetin më të lartë e rrjedhimisht përmes makinerisë më moderne në rajon të prodhojmë ushqimet më cilësore në vend. Trajtim profesional e human deri te produktet bio natyrale. Qumështorja Drena me produkte 100% natyrale dhe të freskëta.



Figura 4.2 Makineria në qumështoren Drena

Qumështorja Drena është e pajisur me teknologjinë më moderne, dhe duke qenë e pajisur me makineri moderne, i respekton në përpikmëri edhe standardet e rregullativës ushqimore HACCP dhe ISO me të cilat edhe është e certifikuar.

4.3 Produktet

Të gjitha produktet e qumështores Drena janë të prodhuara nga fermat vendore. Konsumi i produkteve vendore duhet të jetë një prej parimeve të jetës së përditshme. Qumështi i qumështores Drena vjen drejtpërsëdrejti nga kafshët e ushqyera në natyrë e cila ka impakt direkt në shëndetin e njeriut. Drena garanton me produkte 100% natyrale, bio dhe me yndyrë shtazore pa asnjë shtesë të huaj. Drena ju garanton produkte bio; çdo gjë fillon nga ushqimi i kafshëve tona i cili është 100% bio dhe natyral. Mirëqenia ndaj kafshëve sjell edhe cilësi më të mirë të produkteve.



Figura 4.3 Produktet e Drenës - Kumësht

Pije e freskët për një jetë të shëndetshme. Kumshta është një prodhim i qumështit i cili përmban yndyrë qumësti 0.3g, karbohidrate 0.5gr, vlera energjetike 10kcal/42kj dhe kripë 0.5gr. Këto vlera ndihmojnë trupin në ruajtjen dhe fitimin e energjisë, ruajtjen e shëndetit të zemrës.

Qumësht UHT Drena 1.5% yndyrë. Qumështi është i mbledhur nga fermerët tanë e tokat tona; nga kullosat e Kosovës drejt në tryezat e juaja. Qumështi UHT (Ultra High Temperature) është qumësht afatgjatë i sterilizuar në temperaturë +138 gradë Celsius deri në +140 gradë për një kohë shumë të shkurtër(4-8 sekonda). Sipas studimeve shkencore, koha e trajtimit në temperaturë të tillë është 1-2 sekonda. Të gjitha vlerat ushqyese të qumështit janë ruajtur, si para, ashtu edhe pas trajtimit termik.



Figura 4.4 Produktet e Drenës- Qumështi Uht

Kosi është një produkt i qumështit i bërë nga fermentimi i qumështit me një kulturë kos. Ajo siguron proteina dhe kalcium, dhe mund të përmirësojë bakteret e shëndetshme të zorrëve.



Figura 4.5 Produktet e Drenës- Kos

Përfitimet shëndetësore variojnë nga mbrojtja kundër osteoporozës deri në lehtësimin e sëmundjes së zorrës së irrituar dhe ndihmën e tretjes . 100% i freskët dhe natyral.

Jogurt nga qumësht i freskët lope, i pasterizuar dhe i homogjenizuar, kulturë qumështi, 2.8% yndyrë qumështi. Të ruhet në temperaturë prej +4°C deri në +10°C. 100% i freskët dhe natyral. Jogurti përmban disa nga pothuajse çdo lëndë ushqyese që i nevojitet trupit tuaj.



Figura 4.6 Produktet e Drenës - Jogurt



Figura 4.7 Produktet e Drenës - Jogurt 2.8 %



Figura 4.8 Produktet e Drenës- Llojet e djathit të bardhë

Djathi është prodhuar nga i qumështi kualitetit shumë të mirë, i trajtuar sipas standarteve të larta me teknologjinë më të avancuar me proces prodhimi mirë të kontrolluar. Është i pasur me: materie minerare, kalcium klorid, fosfor, kalium, farë djathi, proteina të çmuara, vitamina A, D, E dhe vitaminat e grupit B.



Figura 4.9 Produktet e Drenës- Ajkë

Ajka është e pasur me yndyrë dhe përmban një sasi të vogël të karbohidrateve dhe proteinës. Është një burim i mirë i vitaminës A dhe kontribon në disa riboflavinë (vitamina B2). Ajka përmban më pak yndyrë dhe më pak kalori.





Figura 4.10 Produktet tjera të Drenës

4.3.1 Çmimet

Qumështorja Drena mundohet të ofrojë produkte me çmime të arsyeshme, në mënyrë që të gjithë qytetarët e vendit të kenë mundësi të përballojnë blerjen e produkteve të qumështores Drena. Qumështorja Drena synon që të jetë sa më afër konsumatorit dhe të jetë prezent në çdo familje. Çmimin e produkteve finale kryesisht e përcaktojnë duke marr parasysh koston e materialit, koston e prodhimit, mbeturinat, transportin si dhe duke ia shtuar përqindjen e fitimit. Pra, metoda e caktimit të çmimit është kryesisht e njëjtë me ndërmarrjet tjera të cilat merrën me veprimtari të tilla prodhuese.

4.3.2 Distribuimi

Qumështorja Drena mundohet të ofrojë produkte të pakrahasueshme si në cilësi ashtu edhe në shërbim. Drena me produktet e freskëta dhe 100% natyrale gjendet në mbarë qytetet e Kosovës, kështu duke qenë prezent tek të gjitha supermarketet dhe marketet e vendit si në: Etc, Viva, Interex, Deppo Market, Conad e Kam.

4.3.3 Promocioni

Në krahasim me vitet e fillimit të qumështores Drena, promocioni i kompanisë ka evoluar dukshëm. Drena përmes promocionit televiziv ka ndikuar pozitivisht që konsumatorët të informohen për produktet dhe risitë që i ka pasur qumështorja. Web faqja zyrtare e qumështores

gjithashtu ka ndihmuar shumë konsumatorët për të u bindur rreth produkteve të Drenës, ku për secilin produkt përshkruhet përmbajtja dhe dobitë shëndetësore të atij produkti. Në ueb faqe gjithashtu është mundësia që konsumatorët të bëjnë pyetje, kritike apo sugjerime rreth produkteve. Konsumatorët e kanë mundësinë të informohen edhe përmes rrjeteve sociale si Facebook e Instagram ku qumështorja i ka llogaritë zyrtare.

4.4 Swot analiza e qumështores Drena

Analiza SWOT përdoret për të përfituar sa më shumë nga ato që kemi, në avantazhin më të mirë të biznesit. Dhe kështu mund të zvogëlohen shanset e dështimit, duke kuptuar se çfarë mungon, dhe duke eliminuar rreziqet që përndryshe do t'ju kapnin të pavetëdijshëm (Mindtools, 2020).




Figura 4.11 SWOT analiza e qumështores Drena

5. REZULTATET E HULUMTIMIT ME PYETËSOR

5.1 Analiza e të dhënave dhe prezantimi i rezultateve

Për analizimin e zinxhirit të vlerës së qumështit në bashkëpunim me mentorin tim të temës së diplomës kemi zgjedhur “Metodën e vlerësimit të shpejtë”. Metoda e formuluar dhe aprovuar nga FAO, e cila është provuar dhe ka dhënë një qasje të zbatueshme dhe me kosto efektive për analizën e sistemeve ushqimore. Në përgjithësi, shumë organizata qeveritare dhe joqeveritare kanë adoptuar këtë qasje të përgjithshme në studime, dhe kanë gjeneruar një grup të madh informacioni mbi organizimin dhe performancën e zinxhirëve të vlerës të kulturave të ndryshme bujqësore ose produkteve bujqësore, në nivelet kombëtare dhe rajonale. Pyetëtori është i ndarë në tri pyetje thelbësore që përfshijnë: Kontrollueshmëria, Relevanca, Pesha. Këto tri pyetje kanë marrë përgjigje në secilin faktor dhe nënfaktorë të pyetësorit në mënyrë që në fund të hulumtimit kemi fituar një gjendje reale të zinxhirit të vlerës në sektorin e qumështit në Kosovë.


Faktorët që i kemi përcaktuar si tregues të zinxhirit të vlerës në pyetësor janë:

- Tregu ndërkombëtar;
- Makroekonomia;
- Qumështi Uht;
- Ambienti;
- Paisjet;
- Inputet;
- Fuqia punëtore;
- Struktura e tregut;
- Menaxhimi në fermë;
- Rregullativa e sigurisë ushqimore;
- Inspektimi;
- Koordinimi i zinxhirit.

Gjithësej janë 13 faktorë, të cilët përmbajnë edhe nënfaktorët përkatës, në mënyrë që përmes pyetësorit të pasqyrohet gjendje reale e zinxhirit të vlerës së qumështit. Numri i pyetësoreve të realizuar është gjithësej 21.

5.2 Rezultatet e hulumtimit

5.2.1 Kualifikimi i respondentëve




Grafiku 5.1- Kualifikimi i respondentëve në %

Pyetësori është realizuar vetëm me ekspertë të fushës, kështu duke përfshirë profesorë të Fakultetit të Bujqësisë, zyrtarë të Ministrisë së Bujqësisë, njohës të fushës nga USAID dhe GIZ, përfaqësues të qumështores Drena dhe qumështoreve tjera vendore, dhe njohës të fushës me një përvojë shumëvjeçare në bujqësi. Duke marrë parasysh që të gjithë të intervistuarit janë ekspertë të fushës, të gjithë kanë shkollim të lartë. 62% apo 13 prej të intervistuarve kanë përfunduar studimet e Doktoratës, 19% ose 4 prej tyre kanë përfunduar studimet Master dhe 19% ose 4 prej tyre kanë përfunduar studimet Bachelor.

5.2.2 Mesatarja e përgjigjeve të respondentëve

Sipas përgjigjeve të respondentëve, pasi është kalkuluar mesatarja e të gjithë pyetësorëve, faktorët “Rregullativa e Sigurisë Ushqimore” dhe “Qumështi UHT” rezultuan që kanë dhënë kontribut me të madh në performancën e zinxhirit të vlerës së qumështit. Sipas respondentëve respektimi i


rregullativës së sigurisë ushqimore është shumë i rëndësishëm dhe ka ndikim pozitiv tek kompanitë dhe ndërmarrjet prodhuese. Çertifikimeve HACCP, GLOBAL GAP, BIO dhe ISO u është dhënë rëndësia dhe pesha e njëjtë. Rëndësi dhe peshë të madhe u është dhënë edhe nënfaktorëve të “Qumështi Uht”, siç janë cilësia e tokës, analiza e tokës, klima dhe madhësia e fermës.



Grafiku 5.2 - Mesatarja e kontributit të faktorëve


Ndërsa faktorëve tjerë u është dhënë dukshëm një peshë dhe rëndësi më e vogël, sa i përket kontributit të tyre në performancën e zinxhirit të vlerës së qumështit. Hapja e tregut luan një rol të rëndësishëm në ekonomi në shumë aspekte. Është dëshmuar se tregtia ndërkombëtare është një nga faktorët më të rëndësishëm të rritjes dhe zhvillimit ekonomik, duke rezultuar në të ardhura më të larta dhe rritje të mirëqenies për shoqërinë. Dihet se procesi i anëtarësimit në BE ka efekte të rëndësishme pozitive, pavarësisht ndikimit fiskal të kësaj marrëveshjeje në Kosovë.

5.2.3 Tregu ndërkombëtar



Grafiku 5.3 - Vlerësimi i relevancës në % sipas responentëve

Nga përgjigjet e përgjithshme të responentëve nga grafiku 3 i paraqitur, e vërejmë se një numër më i madh i responentëve apo 48% e kanë vlerësuar si të favorshëm efektin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit. Ndërsa 29 % e përgjigjeve kanë qenë se MSA ka dhënë efekt neutral në ekonominë e vendit, e sidomos në sektorin e bujqësisë. Numër më i vogël i ekspertëve mendojnë që efekti i kësaj marrëveshje ka qenë i pafavorshëm, gjerësisht shumë i pafavorshëm. Duke e ditur që CEFTA është krijuar me qëllim të eliminimit të pengesave për tregtinë reciproke mes shteteve anëtare; krijimin e kushteve të favorshme për zhvillimin dhe diversifikimin e tregtisë; nxitjen e bashkëpunimit tregtar dhe ekonomik; intensifikimin e marrëdhënieve ekonomike për përfitim reciprok dhe për kontributin në procesin e integritimit në BE; kontribut në zhvillimin e marrëdhënieve tregtare me BE-në dhe për integrimin në sistemin tregtar shumëpalësh (Institute, 2011). Sipas ekspertëve CEFTA në Kosovë nuk e ka dhënë efektin që pritej, kështu vetëm 33% e responentëve mendojnë se kjo marrëveshje ka dhënë efekt të favorshëm. Ndërsa, 29 % mendojnë se efekti i marrëveshjes CEFTA ka qenë shume i pafavorshëm. Të pafavorshëm i kanë vlerësuar edhe nëfaktorët e tjerë të tregut ndërkombëtar sië janë barrierat jo tarifore, barrierat tarifore dhe tregtinë me vendet e tjera.




Grafiku 1.4 - Vlerësimi i faktorit "Tregu Ndërkombëtar" sipas respondentëve

Kosova ende vazhdon të ballafaqohet me një deficit të jashtëm tregtar mjaft negativ, veçanërisht në tregtinë e mallrave. Fakti që Kosova ka nivelin më të ulët të eksporteve në rajon, dhe nivel shumë të lartë të importit është një shenjë e qartë e vështirësive me të cilat përballen. Nga të gjithë të anketuarit numër më i vogël prej tyre apo 29% kanë dhënë vlerësim negativ të faktorit “Tregu ndërkombëtar”. Ndërsa, 71% e të anketuarëve kanë vlerësuar pozitivisht kontributin e këtij faktori në performancën e zinxhirit të vlerës tek qumështi. Në këtë mënyrë edhe mestarja e përgjigjeve ka rezultuar pozitive, por që vlen të theksohet se ka qenë vlerë e vogël pozitive, që nënkupton se sa i përket faktorit “Tregu ndërkombëtar” së bashku me nënfaktorët Msa, Cefta, Barrierat tarifore dhe jotarifore dhe Tregtia me vendet e tjera kanë hapësirë të mjaftueshme për përmirësim, kështu duke u rritur efekti pozitiv i këtij faktorit në performancën e zinxhirit të vlerës. Sa i përket kontrollueshmerisë së faktorit 67% e respondentëve mendojnë se është faktor i kontrolluar nga qeveria, ndërsa 29% vlerësojnë se është faktor i kontrolluar nga qeveria së bashku me biznesin apo firmën. Vetëm 5% mendojnë se tregu ndërkombëtar si faktor që ndikon në performancën e zinxhirit të vlerës është faktor i pakontrollueshëm.

5.2.4 Hulumtim dhe zhvillim

Në Kosovë tregu i punës karakterizohet me norma të larta të mosaktivitetit dhe papunësisë. Kjo mund të jetë për disa arsye, përfshirë kjamin e numrit të vogël e vendeve të reja të punës. Vlerësohet se pothuajse 60% e popullatës jetojnë në zona rurale, dhe për zhvillimin e sektorit të bujqësisë ka fuqi punëtore të mjaftueshme. Por, se sa vlerësojnë ekspertët se kemi fuqi punëtore të specializuar ka rezultuar se 57% e tyre mendojnë që efekti i fuqisë punëtore deri tash ka qenë i favorshëm ndërsa pjesa tjetër, apo 43% vlerësojnë të kundërtën. Ndërsa sa i përket organizatave të specializuara hulumtuese ekspertët vlerësojnë se nuk është bërë sa duhet në këtë drejtim nga qeveria, 29% e respondentëve e vlerësojnë kontributin e këtyre organizatave si të pafavorshëm ndërsa 28% e vlerësojnë si të favorshëm por gjithmonë duke bërë vërejtje se duhet bërë përmirësime të dukshme në këtë drejtim. Sa i përket kontrollueshmërisë faktori “Kërkim& Zhvillim” së bashku me nënfaktorët fuqia punëtore dhe organizata të specializuara hulumtuese është vlerësuar 57% kontrollohet nga qeveria. Vlerësohet se duhet bërë më shumë organizime hulumtuese në bujqësi, pasi që hulumtimet e bëra deri më sot kanë rezultuar të jenë pozitive në sektorin e bujqësisë, duke u fokusuar në funksionimin më të mirë të zinxhirit të vlerës tek qumështi. Vlerësimet sa i përket këtij faktori siç është paraqitur në grafikun 8 janë kryesisht pozitive,




Grafiku 5.5- Vlerësimi i fuqisë punëtore të kualifikuar në %

por duke kalkuluar mesataren e këtyre vlerësimeve rezulton të jetë një një mesatare pozitive e ulët, kështu duke vlerësuar se nuk ka ngecje apo stagnim sa i përket këtij faktori, por progresi është i nevojshëm dhe i mirëseardhur.



Grafiku 5.6 - Vlerësimi i organizatave të specializuara hulumtuese


ndërsa 33% mendojnë që është një faktor që kontrollohet nga qeveria dhe firma/kompania, pjesa tjetër mendojnë se është një faktor pjesërisht i kontrollueshëm.




Grafiku 5.7 - Vlerësimi i faktorit "R&D" sipas respondentëve

5.2.5 Qumështi UHT


Faktori “Qumështi Uht” në hulumtim ka qenë një ndër faktorët të vlerësuar më pozitivisht nga të gjithë faktorët e tjerë që kemi zgjedhur për të vlerësuar performancën e ZV. Kosova disponon kushte të mira klimatike dhe agroekologjike që krijon ambient të përshtatshëm për zhvillimin e sektorëve të veçantë të bujqësisë në regjionet përkatëse. Kështu, edhe ekspertët e kanë vlerësuar shumë të favorshëm kontributin e nënfaktorit “Cilësia e tokës”. 52% e kanë vlerësuar të favorshëm këtë kontribut, ndërsa 33% e kanë vlerësuar si shumë të favorshëm. Analizat e tokës shihen si nënfaktorë shumë të rëndësishëm, por që fatkeqësisht në vendin tonë nuk praktikohen në nivelin e kënaqshëm. Në të gjitha fermat me të cilat qumështorja “Drena” bashkëpunon për grumbullim e qumështit kryhen analizat e tokës dhe sipas tyre kjo ka efekt pozitiv në prodhimtarinë e qumështit. 43% e vlerësojnë shumë të favorshëm efektin e këtij nënfaktori, 24% si të favorshëm dhe 19% vlerësojnë se kontributi i deritanishëm është i pafavorshëm ndërsa pjesa e mbetur mendojnë se në prodhimtarinë e qumështit analizat e tokës nuk kanë ndonjë ndikim.



Grafiku 5.8 - Vlerësimi i nënfaktorit "Cilësia e tokës"



Grafiku 5.9 - Vlerësimi i nënfaktorit "Analizat e tokës"




Grafiku 5.10- Vlerësimi i faktorit "Qumështi Uht" sipas respondentëve


5.2.5 Pajisjet

Ky faktor vlerësohet pozitivisht nga ekspertët për kontributin në performancën e zinxhirit të vlerës. Prandaj edhe mesatarja e përgjigjeve të ekspertëve është mesatare e kënaqshme pozitive. Ekspertët

vlerësojnë të favorshëm kontributin e teknologjisë së përdorur dhe asistencës së ofruar teknike. Në qumështoren Drena përdoret teknologji moderne në prodhimin e qumështit UHT, edhe qumështoret e tjera të vendit posedojnë pajisje moderne. 57% mendojnë se kontributi i teknologjisë së



Grafiku 5.11- Vlerësimi i nënfaktorit "Teknologjia e përdorur"




Grafiku 5.12 - Vlerësimi i nënfaktorit "Asistenca teknike"

përdorur deri tani ka dhënë efekt të favorshëm në performancën të ZV, ndërsa 24% e vlerësojnë si shumë të favorshëm. Asistenca teknike vlerësohet negative, sipas ekspertëve duhet të punohet më shumë në këtë drejtim nga ana e qeverisë, në mënyrë që të mos mungojë ofrimi i ndihmës në zhvillimin e të gjithë sektorëve të bujqësisë. Asistenca teknike e

ofruar nga qumështoret stafit vlerësohet shumë e favorshme. 52% mendojnë se kontributi i këtij nënfaktori është i pafavorshëm, ndërsa vetëm 19% e vlerësojnë si të favorshëm këtë kontribut.


5.2.6 Struktura e tregut



Grafiku 5.13- Vlerësimi i relevancës në % i nënfaktorëve

Sipas grafikut 14, shohim se përqindje më e madhe e të anketuarëve mendojnë se nënfaktorët e faktorit “Struktura e tregut” kanë dhënë kontribut të pafavorshëm deri më tani në performancën e ZV. Tregu vendor në krahasim me tregun rajonal qëndron më mirë sipas ekspertëve kështu 48% prej tyre e vlerësojnë si kontribut të favorshëm, respektivisht vetëm 10% mendojnë se tregu rajonal ka dhënë kontribut të favorshëm. Sa i përket Kontratave/Kushteve të pagesës ekspertët vlerësojnë se në vitet e fundit kanë pasur ndryshim të dukshëm pozitiv. 48% e vlerësojnë si të favorshëm këtë kontribut, dhe po aq e vlerësojnë si të pafavorshëm kështu duke i përfshirë të gjitha kompanitë që bashkëpunojnë me fermerë dhe marrëveshjet e tyre nuk i lidhin me anë të kontratës. Sa i përket kontrollueshmërisë 71% mendojnë se tregun vendor kontrollohet nga qeveria së bashku me bizneset, ndërsa pjesa tjetër mendojnë se është një faktor pjesërisht i kontrollueshëm. Tregu rajonal kontrollohet nga qeveria dhe bizneset/fermat, kështu mendojnë 33%, 38% nga qeveria dhe pjesa tjetër apo 29% vlerësojnë se është një faktor pjesërisht i kontrollueshëm. Sa i përket vlerësimit të faktorit

“Struktura e tregut” ekspertët e kanë vlerësuar peshën dhe kontributin e këtij faktori si kryesisht negativ dhe me ngecje sa i përket ndikimit në performancën e zinxhirit të vlerës të qumështit. Tregu vendor qëndron më mirë se ai rajonal, por që diqka që është theksuar ka qenë vërshimi i tregut vendor me produkte të importuara nga vendet e jashtme. Kosova ka kapacitet të prodhojë dhe të mbulojë tregun vendor të qumështit. Por, që edhe sipas ekspertëve të qumështoreve prodhuesit vendor dëmtohen shumë nga konkurenca e huaj. Kosova gjithashtu synon që të rrit kapacitetin dhe fuqinë prodhuese të deportojë edhe në vendet e tjera, por që deri tash nuk ka pasur lëvizje pozitive në këtë aspekt.




Grafiku 5.14 - Vlerësimi i faktorit "Struktura e tregut" sipas respondentëve

Në grafikun 15 janë paraqitur përgjigjet e vlerësimit të faktorit “Struktura e tregut”, nga grafiku shohim se ekspertët kanë dhënë vlerësim kryesisht negativ të kontributit të këtij faktori në performancën e zinxhirit të vlerës të qumështit.


5.2.7 Makroekonomia

Sa i përket kredive bujqësore dhe kushteve që ofrohen nga institucionet financiare dhe mikrofinanciare në vendin tonë rezultojnë të jenë shumë të pafavorshme. Edhe pse në krahasim me vite më parë, sot fermerët më lehtë përfitojnë kredi por që kushtet që i ofron banka janë shumë të pafavorshme për fermerët. Norma shumë e lartë e interesit është një ndër faktorët kryesorë që fermerët dëmtohen nga marrja e kredive. 29% e vlerësojnë si të pafavorshme marrjen e kredive bujqësore, 19% shume të pafavorshme, ndërsa 19% e vlerësojnë se marrja e kredive është e

favorshme dhe se fermerët për të operuar më mirë me bizneset bujqësore duhet të e shohin si mundësi të mirë marrjen e kredive.




Grafiku 5.15 – Vlerësimi i nënfaktorëve ne % sipas respondentëve



Grafiku 5.16 - Vlerësimi i nënfaktorëve në % sipas respondentëve

Sa i përket të ardhurave në sektorin e qumështit 43% mendojnë se kontributi i këtij nënfaktori është i favorshëm, 10% shumë të favorshëm, kurse një përqindje më e vogël 24% e shohin jo të favorshëm këtë kontribut, pjesa tjetër kanë mendim neutral se nuk ka ndonjë ndikim në performancë të ZV. Sa i përket kontrollueshmërisë, kredia dhe nënfaktorët norma e interesit,


periudha Grace dhe Hipoteka janë faktorë të pakontrollueshëm, ndërsa nënfaktorët e tjerë të paraqitur janë faktorë të kontrolluar nga qeveria dhe fermat.



Grafiku 5.17 - Vlerësimi i faktorit "Makroekonomia"

Grafiku 18 paraqet vlerësimet e ekspertëve sa i përket faktorit "Makroekonomia". Niveli i lartë i importit dhe niveli i ulët i eksportit rezultojnë në një performancë jo të mirë të këtij faktori në kuadër të performancës së zinxhirit të vlerës. Mesatarja e vlerësimeve është pozitive, por mesatare ekstrem e ulët. Prandaj, këtu sipas ekspertëve shihet qartë ngecja e zinxhirit të vlerës së qumështit në vendin tonë.


5.2.8 Rregullativa e sigurisë ushqimore



Grafiku 5.18 - Vlerësimi i nënfaktorit "HACCP"


pafavorshëm. Vlerësim pozitiv kanë dhënë edhe për kontributin e rregullativës ushqimore të sigurisë ISO, 50% e kanë vlerësuar të favorshëm këtë kontribut, 25% shumë të favorshëm, 10%

Grafiku 5.19 - Vlerësimi i nënfaktorit "ISO"




Rregullativa e sigurisë ushqimore HACCP ka rëndësi të madhe për prodhim të ushqimit në raport me konsumatorët. Me implementimin e saj sigurohet prodhim dhe qarkullim i ushqimit të siguruar shëndetsor. Aplikimi i tij është i zgjeruar në botën e zhvilluar, derisa në BE është edhe me ligj obligativ. Shumë të favorshme aplikimin e këtyre rregullativave e vlerësojnë edhe ekspertët e anketuar. 48% e vlerësojnë të favorshëm këtë kontribut, 29% shumë të favorshëm, ndërsa vetëm 9% e vlerësuan neutral dhe 9% gjithashtu të pafavorshëm. Vlerësim pozitiv kanë dhënë edhe për kontributin e rregullativës ushqimore të sigurisë ISO, 50% e kanë vlerësuar të favorshëm këtë kontribut, 25% shumë të favorshëm, 10% kontributin e vlerësojnë neutral dhe 10% të pafavorshëm. Qumështorja Drena me qëllim të prodhimit të produkteve sa më të sigurta për konsumatorët, është e çertifikuar me standardet HACCP dhe ISO. 71% mendojnë se çertifikimi me standardet e rregullativës kontrollohet nga vetë firma ndërsa 29% mendojnë se ky faktor është i kontrolluar nga firma së bashku me qeverinë.

5.2.9 Koordinimi i ZV



Grafiku 5.20 - Vlerësimi i relevancës "Koordinimi i ZV" sipas respondentëve

Në përgjithësi kemi një vlerësim pozitiv të faktorit "Koordinimi i zinxhirit të vlerës" së bashku me nënfaktorët koordinimi vertikal, koordinimi horizontal, rrjeti i informacionit dhe lidhjet tregtare. Koordinimi vertikal është vlerësuar që ka dhënë një kontribut të favorshëm në performancën e zinxhirit të vlerës së qumështit, 57% e ekspertëve e vlerësojnë të favorshëm këtë kontribut, 29% e vlerësojnë se kontributi ka qenë neutral ndërsa 14% e vlerësojnë të pafavorshëm. Koordinimi horizontal është vlerësuar nga ekspertët se efekti i këtij faktori ka qenë neutral, e vlerësuar nga 48% e të anketuarëve, të pafavorshëm e kanë vlerësuar 38%, ndërsa të favorshëm 10%. Rjeti i informacionit dhe lidhjet tregtare janë vlerësuar të favorshme nga 57% e ekspertëve. Koordinimi vertikal kontrollohet 62% nga vetë firma, 19% nga firma së bashku me qeverinë, pjesa tjetër mendojnë se është faktor pjesërisht i kontrollueshëm. Përqindje më e lartë 52% mendojnë se koordinimi horizontal kontrollohet nga firma, 33% mendojnë se është një faktor pjesërisht i kontrollueshëm. Rjeti i informacionit vlerësohet se kryesisht kontrollohet nga vetë bizneset në bashkëveprim me qeverinë, ndërsa lidhjet tregtare janë vlerësuar gjithashtu se janë faktor i kontrolluar nga bashkëpunimi i firmave me qeverinë.



Grafiku 2- Vlerësimi i faktorit "Koordinimi i ZV" sipas respondentëve

Në grafikun 22 janë paraqitur vlerësimet e respondentëve në lidhje me faktorin “Koordinimi i ZV”. Në grafik shohim se përgjigjet janë kryesisht pozitive dhe nga këto vlerësime është fituar mesatare pozitive mesatarisht e kënaqshme në krahasim me faktorët e tjerë të analizuar në hulumtim.

5.3 Vërtetimi i hipotezave

H_0 : Koordinimi vertikal, në krahasim me atë horizontal nuk ka ndikim më të madh në performancën e zinxhirit të vlerës së qumështit

H_1 : Koordinimi vertikal, në krahasim me atë horizontal ka ndikim më të madh në performancën e zinxhirit të vlerës së qumështit.

	<i>Koordinimi vertikal</i>	<i>Koordinimi horizontal</i>
Mean	0.4286	-0.476190
Variance	0.5571	0.561905
Observations	21	21
Pooled Variance	0.5595	
Hypothesized Mean	0	
Df	40	
t Stat	3.9194	
P(T<=t) one-tail	0.0002	
t Critical one-tail	1.6839	
P(T<=t) two-tail	0.0003	
t Critical two-tail	2.0211	

Tabela 5.1-Testimi i hipotezës së parë me T- test

$$H_0 : \mu_v - \mu_h \leq 0$$

$$H_1: \mu_v - \mu_h > 0 \text{ meqenese } t > 1.6839$$

$t = 3.9194$ e hudhim hipotezën H_0 dhe e mbajmë H_1 me të cilën vërtetohet se sipas hulumtimit të bërë rezulton se ne jemi të sigurtë 95% se koordinimi vertikal, në krahasim me atë horizontal ka ndikim më të madh në performancën e zinxhirit të vlerës së qumështit.

H_0 : Politikat qeveritare nuk ndikojnë pozitivisht në performancën e zinxhirit të vlerës së qumështit

H_1 : Politikat qeveritare ndikojnë pozitivisht në performancën e zinxhirit të vlerës së qumështit

<i>Politikat bujqesore</i>	
Mean	-0.19048
Variance	1.36190
Observations	21
Hypothesized Mean	0
Df	20
t Stat	-0.74796
P(T<=t) one-tail	0.23160
t Critical one-tail	1.72472
P(T<=t) two-tail	0.46319
t Critical two-tail	2.08596

Tabela 5.2- Testimi i hipotezës së dytë me T-test

$H_0 : \mu \leq 0$

$H_1: \mu > 0$ meqenëse $t < 1.72472$

$t = 1.72472$ atëherë e mbajmë hipotezën bazë më të cilën sipas hulumtimit të bërë ne jemi 95% të sigurtë se politikat qeveritare nuk ndikojnë pozitivisht në performancën e zinxhirit të vlerës së qumështit.

H_0 : Teknologjia e përdorur në kompani nuk ndikon në ngritjen e performancës së kompanisë

H_1 : Teknologjia e përdorur në kompani ndikon në ngritjen e performancës së kompanisë

	<i>Teknologjia</i>
Mean	0.57143
Variance	0.65714
Observations	21
Hypothesized Mean	0
Df	20
t Stat	3.23029
P(T<=t) one-tail	0.00210
t Critical one-tail	1.72472
P(T<=t) two-tail	0.00420
t Critical two-tail	2.08596

Tabela 5.3- Testimi i hipotezës së tretë me T- test

$H_0 : \mu \leq 0$

$H_1: \mu > 0$ meqenëse $t > 1.72472$

$t = 3.23029$ atëherë e hudhim hipotezën bazë dhe e mbajmë hipotezën alternative me anë të cilës sipas hulumtimit të bërë vërtetojmë se jemi 95% të sigurtë se teknologjia e përdorur në kompani ndikon në ngritjen e performancës.

H₀: Zinxhiri i vlerës nuk funksionon më mirë te qumështi UHT sesa tek produktet e tjera të qumështit

H₁: Zinxhiri i vlerës funksionon më mirë te qumështi UHT sesa tek produktet e tjera të qumështit

	<i>Qumeshti Uht</i>
Mean	0.5238
Variance	0.9619
Observations	21
Hypothesized Mean	0
Df	20
t Stat	2.4475
P(T<=t) one-tail	0.0119
t Critical one-tail	1.7247
P(T<=t) two-tail	0.0237
t Critical two-tail	2.0860

Tabela 5.4- Testimi i hipotezës se katërt me T- test

$$H_0 : \mu \leq 0$$

$$H_1: \mu > 0 \quad \text{meqenëse} \quad t > 1.7247$$

$t = 2.4475$ atëherë e hudhim hipotezën bazë dhe e mbajmë hipotezën alternative, sipas së cilës në bazë të hulumtimit të bërë jemi të sigurtë 95% se zinxhiri i vlerës funksionon më mirë te qumështi UHT sesa tek produktet e tjera të qumështit.

5. 4 - PËRFUNDIMI DHE REKOMANDIMET

5.4.1 Përfundimi

Lufta e fundit në Kosovë dëmtoi rëndë sektorin e qumështit duke shkaktuar djegien e mijëra fermave dhe asgjësimin e rreth gjysmën e bagëtive. Rënia drastike e prodhimit të qumështit ndikoi në ngritjen e papunësisë dhe të deficitit tregtar agro-ushqimor, ndërkaq mundësitë e zhvillimit të këtij sektori përmes investimeve, ishin pothuajse të pamundshme për shkak të qasjes së kufizuar të fermerëve në shërbime kreditore. Vërehet dukshëm se vitet e fundit në krahasim me vitet e pasluftës ka shënuar progres, jo vetëm sektori i qumështit por të gjithë sektorët e bujqësisë në përgjithësi. Qëllimi i këtij hulumtimi ka qenë të analizohet zinxhiri i vlerës te sektori i qumështit në vendin tonë, e në veçanti të analizohet ai i qumështit UHT në kompaninë Drena. Pjesën e rishikimit të literaturës është paraqitur gjendja reale e sektorit të qumështit në vendin tonë, në mënyrë që edhe hulumtimi i bërë të fokusohet në pika të rëndësishme të temës së zgjedhur. Përveç kësaj edhe një përshkrim rreth definimit dhe analizimit të zinxhirit të vlerës në bujqësi, gjithmonë duke u fokusuar në zinxhirin e vlerës së qumështit. Faktorët e analizuar të zinxhirit të vlerës në hulumtim kanë paraqitur një pasqyrë momentale sa i përket zinxhirit të vlerës së qumështit. Hulumtimi është realizuar duke intervistuar ekspertë të fushës në mënyrë që rezultatet të jenë të besueshme dhe reale.

Qëllimi i kompanisë për të cilën kam hulumtuar është të frymëzojë një shoqëri të shëndoshë duke lidhur njerëzit me ushqim të vërtetë. Ndërsa rritet dhe zgjerohet si kompani së bashku, ta rris dhe kënaqësinë e blerësve duke ofruar prodhimet më të freskëta në mënyrën më miqësore, me nder dhe me komunikim të sinqertë. Suksesi i kompanisë bazohet në komunikimin e sinqertë me konsumatorët, produktet natyrale dhe të freskëta. Pikë tjetër e fortë e kompanisë është edhe hulumtimi për gjetjen e recetave të reja me shije dhe cilësi të reja. Qumështorja Drena punon sipas parimit ekonomik “Konsumatori është mbret”, dhe në këtë mënyrë konsumatori gjithmonë është parësori dhe se puna e kompanisë varet nga preferencat e konsumatorëve. Konsumatori është parësor dhe kështu kompania synon të shërbejë produkte të sigurta, cilësore dhe të shëndetshme.

Në cilësinë e mirë të produkteve të qumështores ndikon edhe posedimi i teknologjive moderne të prodhimit. Gjatë hulumtimit që kam zhvilluar në kuadër të punimit tim të masterit, kam arritur në përfundim se edhe çmimet e lira stimulojnë shitjen, nxisin konsumatorët që të bëjnë blerje në

produktet e ofruara në treg. Çmimet e arsyeshme të qumështores Drena janë gjithashtu edhe një pikë pozitive që ndikon edhe në performancën e kompanisë.

Produktet e qumështores Drena janë produkte që konsumohen nga konsumatorët e të gjitha moshave dhe në mbarë vendin. Qumështi UHT, është qumësht i mbledhur nga fermerët vendorë dhe i sterilizuar në mënyrë që të gjitha vlerat ushqyese të ruhen, si para ashtu edhe pas trajtimit. Në këtë mënyrë edhe konsumatorët e qumështit UHT të prodhuar nga qumështorja Drena të konsumojnë produkt të sigurtë dhe të shëndetshëm.

Drena përmes promocionit televiziv ka ndikuar pozitivisht që konsumatorët të informohen për produktet dhe risitë që i ka pasur qumështorja. Web faqja zyrtare e qumështores gjithashtu ka ndihmuar shumë konsumatorët për të u bindur rreth produkteve të Drenës, ku për secilin produkt përshkruhet përmbajtja dhe dobitë shëndetësore të atij produkti. Në web faqe gjithashtu është mundësia që konsumatorët të bëjnë pyetje, kritike apo sugjerime rreth produkteve. Konsumatorët e vlerësojnë transparencën e treguar nga qumështorja dhe kështu forcohet besueshmëria në produkte.

5.4.2 Rekomandimet

Bazuar në konkluzionet e mësipërme dhe hulumtimit të bërë do të paraqesim edhe një varg rekomandimesh të cilat u dedikohen institucioneve relevante, kompanisë për te cilën kam hulumtuar, por edhe bizneseve që merren me sektorin e qumështit.

- Rekomandohet që institucionet përkatëse të stimulojnë bizneset e reja bujqësore dhe fermerët e rinjë të zhvillojnë prodhimtarinë e qumështit, me qëllim të zhvillimit të sektorit, rritjes së eksportit si dhe zvogëlimit të importit.
- Rekomandohet që institucionet përkatëse të rishikojnë infrastrukturën ligjore, meqenëse sipas hulumtimit vlerësohet se ka ngecje në hartimin dhe implementimin e politikave.
- Rekomandohet që institucionet përkatëse të kryejnë vizita më të rregullta sanitare, në mënyrë që edhe konsumatorët të ndryshojnë bindjen se produktet vendore janë më pak cilësore se ato të importuara.
- Rekomandohet që qumështorja Drena të sjell produkte të reja në treg, gjithmonë duke vlerësuar shijet dhe preferencat e konsumatorëve.

- Rekomandohet që qumështorja Drena të mbajnë organizime informuese në zonat rurale të vendit në mënyrë që të motivohen edhe fermerët e rinjë për të vazhduar në këtë sektor.
- Rekomandohet që qumështorja Drena të rrit tendencën për ngritje të kapacitetit dhe rritje të nivelit të eksportit të produkteve në tregun rajonal.
- Rekomandohen bizneset që përveç profitit individual, të synojnë edhe vendosjen e mirëqenies sociale dhe hapjen e vendeve të reja të punës.
- Rekomandohen bizneset bujqësore të rritin numrin e punëtorëve të kualifikuar, që do të ndikojë pozitivisht edhe në performancë të bizneseve.
- Rekomandohet konsumatorët që të u japin përparësi produkteve vendore në krahasim me produktet e importuara.

Literatura e përdorur

Chavan, R. S., Chavan, S. R., Khedkar, C. D., & Jana, A. H. (2011, August 22). *UHT Milk Processing and Effect of Plasmin Activity on Shelf Life: A Review*. Gjetur August 22, 2011, nga Wiley Online Library: <https://onlinelibrary.wiley.com/doi/epdf/10.1111/j.1541-4337.2011.00157.x>

Coats, S. J., Auld, M. J., Sutherland, B. J., & Hardham, J. F. (1996). *Effect of somatic cell count and stage of lactation on the quality and storage life of ultra high temperature milk*. *J Dairy Res.*

Harvard Business School. (a.d.). *The Value Chain*. Gjetur në INSTITUTE FOR STRATEGY & COMPETITIVENESS: <https://www.isc.hbs.edu/strategy/business-strategy/Pages/the-value-chain.aspx>

Karlsson, M. A., Langton, M., Innings, F., Malmgren, B., Höjer, A., Wikström, M., & Lundh, Å. (2019, September 5). *Changes in stability and shelf-life of ultra-high temperature treated milk during long term storage at different temperatures*. Gjetur September 5, 2019, nga NCBI: <https://www.ncbi.nlm.nih.gov/pmc/articles/PMC6745408/>

Ask. (2019). *Anketa e Ekonomive Bujqësore 2019*. Gjetur 2019, nga Agjensia e Statistikave të Kosovës: <https://ask.rks-gov.net/media/5488/anketa-e-ekonomive-bujqesore-2019-2.pdf>

Bank, W. (2018). *Agriculture Finance in Kosovo*. Gjetur 2018, nga World Bank : <https://openknowledge.worldbank.org/bitstream/handle/10986/31288/134583-WP-PUBLIC-12-2-2019-18-17-35-AgricultureFinanceinKosovo.pdf?sequence=1&isAllowed=y>

Berbatovci, I. (2018). Market globalization and its impact on supply chain of dairy industry in Kosovo. *SOCIAL AND NATURAL SCIENCES –GLOBAL CHALLENGE 2018* (fv. 201-205). Vienna: International Institute for Private- Commercial- and Competition Law (Austria) . Gjetur 2018, nga International Institute for Private- Commercial- and Competition Law (Austria) .

Burim Ejupi, D. A. (2015, 08). *Tregu i prodhimeve të qumështit dhe mundësitë e Kosovës për Zhvillim*. Gjetur 08 2015, nga Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP): https://indep.info/wp-content/uploads/publikimet_sq/Tregu%20i%20prodhimeve%20t%C3%AB%20qum%C3%ABshtit%20dhe%20mund%C3%ABsit%C3%AB%20e%20Kosov%C3%ABs%20p%C3%ABr%20Zhvillim%20%5BBurim%20Ejupi%20%20Dardan%20Abazi%20Dhe%20Gent%20Ahmetaj%2C2015%2008%2C%5D.pdf

Bytyqi, H., Rrustemi, M., Mehmeti, H., Kryeziu, A., Gjinovci, V., & Gjonbalaj, M. (2009). *MILK PRODUCTION IN COMMERCIAL CATTLE DAIRY FARMS IN KOSOVA*. Gjetur 2009, nga STOČARSTVO: file:///C:/Users/ok/Desktop/Downloads/Stocarstvo_4_2009_275_285.pdf

D.Dibrani: Analizimi i zinxhirit të vlerës të qumështit. Punim i temës së Masterit. Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Prishtinë, 2021

CGMA. (2013). *Value Chain Analysis*. Gjetur 2013, nga CGMA:

<https://www.cgma.org/resources/tools/essential-tools/value-chain-analysis.html>

D.Thaci. (2018). *ZBATIMI I KONCEPTIT TË MARKETINGUT NË INDUSTRIJË E QUMËSHIT NË KOSOVË- RAST STUDIMI KOMPANIA- Rast Studimor Drena dhe Vita*. Gjetur në Universiteti i Prishtinës:

https://drive.google.com/file/d/1I04qya68Qc_dLbCE3sWi66KpG5GnLcR-/view

Daci-Zejnullahu, E. (2014). *Agriculture Sector in Kosovo And Opportunities for Cooperation With Balkans Countries*. Gjetur 2014, nga Research Gate:

https://www.researchgate.net/publication/319331288_Agriculture_Sector_in_Kosovo_And_Opportunities_for_Cooperation_With_Balkans_Countries

Datta, N., & Deeth, H. C. (2007, March). *Diagnosing the cause of proteolysis in UHT milk*. Gjetur March 2007, nga Research Gate:

https://www.researchgate.net/publication/222339285_Diagnosing_the_cause_of_proteolysis_in_UHT_milk

Datta, N., & Deeth, H. c. (2003, March). *Diagnosing the cause of proteolysis in UHT milk*. Gjetur March 2003, nga Research Gate:

https://www.researchgate.net/publication/222339285_Diagnosing_the_cause_of_proteolysis_in_UHT_milk

Dhakal, E. A., Datta, A., & Deeth, N. (2003). Heat-induced changes in UHT milks. *Heat-induced changes in UHT milks*, Heat-induced changes in UHT milks.

Donovan, J., Franzel, S., Cunha, M., Gyau, A., & Mithöfer, D. (2015, July 15). *Guides for value chain development: a comparative review*. Gjetur July 15, 2015, nga Emerald Insight:

<file:///C:/Users/ok/Desktop/Downloads/GuidesforVCdevelopment-comparativereview-JADEE2015.pdf>

Drena. (2020). *Kush eshte Drena*. Gjetur në Qumeshtorja Drena:

<http://qumeshtorjadrena.com/kompania>

Fao. (2009). *Sustainable Food Value Chains Knowledge Platform*. Gjetur 2009, nga FAO:

<http://www.fao.org/sustainable-food-value-chains/library/details/en/c/266279/>

Fao. (2014, November 27-28). *A knowledge exchange forum for the development of green food value chain*. Gjetur November 27-28, 2014, nga Food and Agriculture Organization of the United Nations :

http://www.fao.org/fileadmin/user_upload/rust/docs/Report%20GFVC-FAO.pdf

Fao. (2015). *Value chains, agricultural markets and food security*. Gjetur 2015, nga Food and Agriculture Organization of the United Nations: <http://www.fao.org/3/a-i5226e.pdf>

- Fao. (2017). *Gateway to dairy production and products*. Gjetur 2017, nga Food and Agriculture Organization of the United Nations: <http://www.fao.org/dairy-production-products/socio-economics/smallholders-in-the-value-chain/en/>
- GAP, I. (2016, Mars). *Analiza per Industrine e Qumeshtit*. Gjetur Mars 2016, nga Analize Politikash: https://www.institutigap.org/documents/12491_Analiza%20p%C3%ABr%20Industrin%C3%AB%20e%20Qum%C3%ABshtit.pdf
- Gaucher, I., Boubellouta, T., Beaucher, E., I Piot, M., Gaucheron, F., & Dufour, E. (2008, May). Investigation of the effects of season, milking region, sterilisation process and storage conditions on milk and UHT milk physico-chemical characteristics: a multidimensional statistical approach. *Dairy Sci Technol*. Gjetur May 2008, nga Springer Link: <https://link.springer.com/article/10.1051/dst:2007022>
- Gereffi, G., & Fernandez-Stark, K. (2011, MAY 31). *GLOBAL VALUE CHAIN ANALYSIS: A PRIMER*. Gjetur MAY 31, 2011, nga Globalizatin Gorvernance& Competitiveness: https://d1wqtxts1xzle7.cloudfront.net/31755091/2011-05-31_GVC_analysis_a_primer.pdf?1377070141=&response-content-disposition=inline%3B+filename%3D2011_05_31_GVC_analysis_a_primer.pdf&Expires=1602080107&Signature=FfCxZjVOflObZ7-NwnxP0oNbp2d3oW61lluH15Q0~1v
- Haas, R., Canavari, M., Imami, D., Gjonbalaj, M., Gjokaj, E., & Zvyagintsev, D. (2016). Attitudes and Preferences of Kosovar Consumer Segments Toward Quality Attributes of Milk and Dairy Products. *Journal of International Food and Agribusiness Marketing*, 407-426.
- Henson, S., & Reardon, T. (2005). FOOD POLICY. Në S. HENSON, & T. REARDON, *Private Agri-Food Standards: Implications for Food Policy and the Agri Food System* (fv. 241-253).
- Institute, G. (2011, March). *Kosova në CEFTA*. Gjetur në Gap Institute: https://www.institutigap.org/documents/34333_KosovaCEFTA.pdf
- Jaud, M., & Kukenova, M. (2011, May). *Financial Development and Survival of African Agri-food Exports*. Gjetur May 2011, nga World Bank: <https://openknowledge.worldbank.org/bitstream/handle/10986/3521/WPS5649.pdf?sequence=1&isAllowed=y>
- LeGrand, T. (2018). *Overviews of food systems and agroindustry, value chains, and food loss and waste in the countries of Eastern Europe and Central Asia*. Budapest: Food and Agriculture Organization of the United Nations.
- Manji, B., Kakuda, Y., & Arnott, D. R. (1986, December). *Effect of Storage Temperature on Age Gelation of Ultra-High Temperature Milk Processed by Direct and Indirect Heating Systems*. Gjetur December 1986, nga Science Direct: <https://www.sciencedirect.com/science/article/pii/S0022030286807615>

D.Dibrani: Analizimi i zinxhirit të vlerës të qumështit. Punim i temës së Masterit. Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Prishtinë, 2021

- Manufacturing, C. U. (2013). *"Decision Support Tools: Porter's Value Chain"*. Cambridge University.
- MBPZHR. (2015, Gusht). Gjetur GUSHT 2015, nga Tregu i qumështit: https://www.mbpzhr-ks.net/repository/docs/Tregu_i_qumeshtit_Final_15_10_2015.pdf
- MBPZHR. (2019). *Raporti i Gjelber*. Gjetur 2019, nga MPBZHR: https://www.mbpzhr-ks.net/repository/docs/Raporti_i_Gjelber_2019_13120.pdf
- Miftari, I. (2009). *Preferencat e sjelljes konsumatore të Kosovarëve dhe kërkesa për qumësht dhe produkte të*. Norvegji : Universiteti Norvegjez i Shkencave të Jetës.
- Miftari, I., Gjonbalaj, M., Gjergjizi, H., Vegara, M., Mehmeti , H., Bytyqi, H., & Bytyqi, N. (2008). *ANALYSIS OF CONSUMER BEHAVIOUR IN REGARD TO DAIRY PRODUCTS IN KOSOVO*. Gjetur 2008, nga https://d1wqtxts1xzle7.cloudfront.net/34773597/Paper_ANALYSIS_OF_CONSUMER_BEHAVIOUR_IN_REGARD_TO_DAIRY_PRODUCTS_IN_KOSOVO_3-46-9.pdf?1411008925=&response-content-disposition=inline%3B+filename%3DANALYSIS_OF_CONSUMER_BEHAVIOUR_IN_REGARD.pdf&Expires=1605192
- Mindtools. (2020). *SWOT Analysis*. Gjetur në How to Develop a Strategy For Success: https://www.mindtools.com/pages/article/newTMC_05.htm
- Musliu, A., Gjonbalaj, M., Sherifi, K., & Meqe, M. (2009). *New Medit*. Gjetur 2009, nga Economic losses related to raw milk quality on commercial dairy farms in Kosovo: http://www.iamb.it/share/img_new_medit_articoli/265_49musliu.pdf
- Neven, D. (2014). *Developing sustainable food value chains – Guiding principles*. Rome. Gjetur 2014, nga Fao: <http://www.fao.org/3/a-i3953e.pdf>
- Nogales, E. G. (2017). *Agribusiness and value chains*. Gjetur 2017, nga Food and Agriculture Organization of the United Nations: <http://www.fao.org/3/a-i6811e.pdf>
- Raphael Kaplinsky and Mike Morris*. (2014, FEBRUARY 24). *A Handbook for Value Chain Analysis*. Gjetur February 24, 2014, nga <http://www.value-chains.org/dyn/bds/docs/395/Handbook%20for%20Value%20Chain%20Analysis.pdf>
- Recura. (2020, March). *ZINXHIRI I VLERËS PËR SEKTORIN E QUMESHTIT*. Gjetur March 2020, nga Recura - Agro Resource Center: <https://agroportal-ks.com/wp-content/uploads/2020/04/6.-Guidebook-QUMESHTI-web-20200402-1.pdf>
- Rositsa Beluhova-Uzunova, G. L. (2020, February). *AGRICULTURAL COMPETITIVENESS: THE CASE OF KOSOVO* . Gjetur February 2020, nga Research Gate: [file:///C:/Users/ok/Desktop/Downloads/05_26_2019%20\(1\).pdf](file:///C:/Users/ok/Desktop/Downloads/05_26_2019%20(1).pdf)

- Stamm, A., & Drachenfels, C. v. (2011). *Value Chain Development*. Gjetur 2011, nga German Development Institute : https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---ed_emp/---emp_ent/---ifp_seed/documents/publication/wcms_170848.pdf
- Steven Haggblade, Veronique Theriault,. (2012). *A Conceptual Framework for Promoting Agricultural Value Chains*. Michican State University. Gjetur në https://web.archive.org/web/20130810130142/http://fsg.afre.msu.edu/IFAD-WA/conceptual_framework.pdf
- TARDI, C. (2020, July 5). *Value Chain*. Gjetur JULY 5, 2020, nga INVESTOPEDIA: <https://www.investopedia.com/terms/v/valuechain.asp>
- UNIDO. (2009). *AGRO-VALUE CHAIN ANALYSIS AND DEVELOPMENT*. Gjetur në UNITED NATIONS INDUSTRIAL DEVELOPMENT ORGANIZATION: https://www.unido.org/sites/default/files/2010-02/Agro_value_chain_analysis_and_development_0.pdf
- Usaid. (2014). *Value Chain Development*. Gjetur në MARKET LINKS: <https://www.marketlinks.org/topics/value-chain-development>
- Varzakas, A. L. (2008). *A Computerized Procedure for Estimating Chemical Changes in Thermal Processing Systems*. American Journal of Food Technology.
- Webber, , M. C., & Labaste, P. (2011). *Building Competitiveness in Africa's Agriculture : A Guide to Value Chain Concepts and Applications*. Gjetur 2011, nga World Bank Group: <https://openknowledge.worldbank.org/handle/10986/2401>